# PLVM

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS
## BASHKIA LEZHË





Bashkia Lezhë

Shoqata EIRLA

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) - Zyra në Shqipëri

Fondacioni SOROS

BASHKIA LEZHË

# PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS

**Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)**
për Europën Qëndrore dhe Lindore
**Zyra në Shqipëri**

**Shoqata**
Eko-Integrim Retina (EIRLA) Lezhë

**Fondacioni**
Shoqëria e Hapur për
Shqipërinë (SOROS)

## PËRMBAJTJA

faqe

1. Hyrje......5

2. Historiku i qytetit të Lezhës ......7

3. Gjendja mjedisore e rrethit Lezhë......8

4. Biodiversiteti i qytetit të Lezhës......15

5. Probleme mjedisore vendore......18

6. Veprimet mjedisore prioritare......24

PLANI I VEPRIMIT......32

## PARATHËNIE



*Përgatitja e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) u realizua nga bashkëpunimi i ngushtë i përfaqësuesve të pushtetit vendor, organizatave jofitimprurëse dhe qytetarëve të rrethit të Lezhës duke diskutuar dhe paraqitur zgjidhje konkrete të problemeve mjedisore në nivel vendor.*

*Ky proçes ka ndihmuar zhvillimin e shoqërisë civile në nivel vendor përmes përgatitjes me metodën e pjesëmarrjes të një plani veprimi për të adresuar prioritetet më të rëndësishme dhe zbatimin e strategjive më efektive në këndvështrimin social, financiar dhe kohor.*

*Sugjerime dhe projekte konkrete për zgjidhjen e problemeve mjedisore dhe përfshirjen aktive të publikut e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë, do të bëjnë të mundur që proçesi i zbatimit të tij dhe tërheqjes së donatorëve për financime në rrethin e Lezhës të jetë i sigurtë.*

**Gjok Jaku**
Kryetar i Bashkisë Lezhë

*Për realizimin e këtij projekti kontribut të veçantë dhanë Z. Ali Brahimi, Kryetar i Shoqatës EIRLA dhe Z. Jak Gjini, Kryetar i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Lezhë, si dhe specialistët që u përfshinë në përgatitjen e këtij Plani.*

**PËR KONTAKTE:**

**Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)**
**për Europën Qëndrore dhe Lindore**
**Zyra në Shqipëri**
**Adresa**: Rruga e Durrësit
P. 11, Shk. 2, Ap. 12, Tiranë
Kutia Postare 127
Tel/Faks: (04) 239 444
E-mail: rec@rec.tirana.al

**Shoqata Eko-Integrim Retina (EIRLA)**
**Adresa:** Shkolla e Mesme e Përgjithshme
"Hydajet Lezha", Lezhë
Tel: (0215) 2294

**Fondacioni SOROS**
**Adresa:** Rruga "Pjetër Bogdani",
Pall. 23/1, Kati i dytë
Tiranë
Tel: (04) 234 621
E-mail: Soros-al@osfa.soros.al

# 1. HYRJE

Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM), janë dokumente të politikës mjedisore vendore, të cilat paraqesin prioritete mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtyre planeve zhvillon më tej aftësitë e pushtetit vendor dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin. Gjithashtu, PLVM nxit bashkëpunimin midis organizatave jofitimprurëse, pushtetit vendor dhe atij qëndror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesmarrjen publike në proçesin e vendim-marrjes.
Hartimi i PLVM-ve është një proçes i domosdoshëm, i cili shkon paralelisht me proçeset e decentralizimit në vendin tonë. Përgatitja e PLVM-së i paraprin kërkesave që Bashkimi Europian parashtron ndaj vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, të cilat kanë filluar proçesin e asociim-stabilizimit me të.

Planet e Veprimit në Mjedis synojnë të:

**- Zgjidhin problemet mjedisore nëpërmjet:**
identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundëshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plani Veprimi.

- **Zhvillojnë shoqërinë civile nëpërmjet:**
forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet duke sjellë së bashku përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që përfaqësojnë interesa të ndryshme në këto komunitete, përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të OJF-ve, biznesin, shkencëtarë, duke shpjeguar teknikat specifike që organizatorët lokalë mund të përdorin për të përcaktuar aktorët kryesorë të proçesit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në proçes, për rekrutimin dhe punën me vullnetarët dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesuara dhe organizatave.

- **Rrisin aftësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetit për:**
paraqitjen e elementëve thelbësore të planit të veprimit të komunitetit: duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, duke përfshirë publikun, përcaktimin e prioriteteve, hartimin e strategjive dhe zhvillimin e një plani veprimi.

- **Rrisin shkëmbimin e informacionit në nivel lokal nëpërmjet:** sjelljes së shembujve dhe modeleve nga plane të mëparshëm të komuniteteve nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.
- **Japin zgjidhje konkrete për problemet komunitare me anë të:** shkëmbimit të përvojave lidhur me përdorimin e aftësive në analizë, planifikim, drejtim, bisedime dhe vlerësime që janë thelbësore për një veprim komunitar efektiv. Duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grup duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpërmjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

## Fazat e përgatitjes së PLVM për qytetin e Lezhës

### Faza e parë

Aktivitetet e realizuara përfshinë:

- përgatitjen e materialeve informuese për publikun rreth PLVM-së;
- përcaktimin e grupeve të punës për hartimin e PLVM-së.

### Faza e dytë

Aktivitetet e realizuara përfshinë:

- identifikimin e problemeve mjedisore nga specialistët lokalë;
- diskutimin e gjërë publik të problemeve të identifikuara me Komitetin Qytetar;
- përgatitjen e aktiviteteve dhe materialeve informuese për publikun rreth problemeve të identifikuara.

### Faza e tretë

Aktivitetet e realizuara përfshinë:

- përcaktimin e veprimeve mjedisore;
- diskutimin e gjërë publik të veprimeve të identifikuara me Komitetin Qytetar;
- përgatitjen e aktiviteteve dhe materialeve informuese për publikun;
- **botimin dhe promovimin e PLVM për Lezhën.**

# 2. HISTORIKU I QYTETIT TË LEZHËS



Qyteti i Lezhës është një qytet që ka jetuar në të njëjtin truall për më tepër se 3 mijë vjet duke pasur si zanafillë qytetin antik ilir të Lisit.
Nga një vend parahistorik, i hapur më vonë për vetëmbrojtje, Akrolisi, i vendosur në majën e malit të Shelbumit, 408 m mbi nivelin e detit, (shek XI p.e.s.) u fortifikua e u bë qendër e rëndësishme paraurbane shumë afër bregdetit lindor të Adriatikut. Më vonë ilirët (shek V p.e.s.) zbritën për kushte më të mira jetese në kodrën e Lisit (ku sot është vendosur kalaja mesjetare) dhe e bënë atë një qytet të mirëfilltë të zhvilluar ekonomikisht e të përmëndur për mbrojtje. Qyteti i Lisit, i vendosur në anën perëndimore të faqes së kalasë e deri në bregun e lumit Drin, është themeluar në fundin e shekullit IV p.e.s. si qytet i mirëfilltë ilir (në kuvendin e dytë të studimeve ilire në vitin 1986 është quajtur qyteti më i madh i Ilirisë). Në periudha të ndryshme ka lulëzuar si qytet, por dhe është djegur, pushtuar e shkatërruar, por gjithnjë i ringritur në këmbë deri sa erdhi në ditët tona.
Ky qytet preu monedhat e veta në katër prerje në shekullin III e II p.e.s. kur kishte kulmin e zhvillimit dhe kishte portin e vet lumor e detar (Lezha është përfshirë në projektet e arkeologjisë botërore të shpëtimit). Sot qyteti i Lezhës ka shumë objekte të rëndësishme arkeologjike e historike si: memoriali e vendvarrimi i Skënderbeut, kalaja mesjetare dhe objekte të qytetit të vjetër Lis (portat, muret rrethuese) etj.
I rrethuar nga laguanat Kunë e Vain, plazhi i bukur i Shëngjinit dhe bukuritë malore të Velës, ky qytet, ndodhet vetëm 70 km në veri të Tiranës dhe 8 km nga bregdeti Adriatik e zgjeruar në të dy anët e lumit Drin. Popullsia prej 22,120 banorësh, e cila i takon 5,660 familjeve, është e vendosur në lagjet Beslidhja, Skënderbeg, Gurra - Varosh, Kodër-Marlekaj, të cilat zënë një sipërfaqe prej 125 ha si dhe lagja SMT.
Me shëndërrimet demokratike, në vitin 1992 qyteti i Lezhës u organizua në Bashki dhe aktualisht në stafin e kësaj strukture janë të punësuar 44 vetë.
Lezha është qendra më e rëndësishme administrative e Qarkut me të njëjtin emër në të cilin ndodhen godina e Qarkut, Prefekturës dhe Bashkisë si dhe e institucioneve që ushtrojnë aktivitet në këtë njësi.

# 3. GJENDJA MJEDISORE E RRETHIT LEZHË

## 3.1 Hyrje

Lezha hyri në rrugën e transformimeve demokratike duke trashëguar një strukturë ekonomike shumë të pazhvilluar dhe një varg problemesh mjedisore. Niveli i ulët ekonomik në njëfarë mase kushtëzoi dhe një gjendje relative të mirë të disa aspekteve të trashëguara të mjedisit nga ana tjetër prioriteti i ulët i çështjeve mjedisore, teknologjitë e vjetëra, praktikat e keqadministrimit, mungesa e informacionit, mungesa e lidhjeve me të huajt, janë disa nga arsyet që qëndrojnë prapa dështimeve në fushën e mjedisit.
Njohja e problematikës komplekse mjedisore dhe e faktorëve që e kushtëzojnë atë është një domosdoshmëri për të hedhur hapa drejt hartimit dhe zhvillimit të planeve strategjike për zhvillim të qëndrueshëm, zhvillimit të një ekonomie në harmoni me mjedisin duke mësuar në të njëjtën kohë dhe nga gabimet e të tjerëve.

## 3.2 Karakteristika të përgjithëshme natyrore të rrethit Lezhë

Lezha shtrihet në pjesën veriore të Ultësirës Perëndimore të Shqipërisë dhe karakterizohet nga një diversitet i larmishëm i relievit, klimave e mikroklimave dhe për pasojë të florës, faunës dhe biodiversitetit në përgjithësi. Sasitë e reshjeve vjetore luhaten nga 1050 – 1100 mm, ndërsa vlerat e temperaturës vjetore luhaten nga 14 – 16 $^{0}$C .

Lezha ka një sipërfaqe prej 47,200 ha prej të cilave 16,781 ha tokë arë, 17,989 ha pyje, 245.2 ha vreshta, pemtari e ullishte, 2,515 ha livadhe, kullota e truall dhe 6,494 ha sipërfaqe ujore, kënetë dhe tokë jobujqësore.
Rrethi i Lezhës ka një popullsi prej 87,491 banorësh nga të cilët rreth 24,000 në qytet ose 28% e saj.





## 3.3 Problemet më kryesore mjedisore në rajonin e Lezhës

### 3.3.1 Shfrytëzimi pa kriter i pyjeve, tendenca degraduese

38 % e sipërfaqes së përgjithëshme të rrethit (47,867 ha) janë pyje (sa është dhe sip. e tokës bujqësore). Mesatarisht 100 $m^3$ lëndë drusore në vit pas vitit 1991 konstatohen zyrtarisht të prera pa leje dhe 1 ha të përshkuar nga zjarri. Gjithashtu, 600 ha fond pyjor janë të ekspozuar ndaj erozionit. Aktivizimi i erozionit ka bërë që në raste reshjesh (dhe vetëm me 80 mm reshje ) të zbresin mijëra ton sterile së bashku me prurjet duke dëmtuar infrastrukturat urbane dhe duke prishur shtresën aktive të tokës bujqësore. Sipërfaqe të mëdha me pyje janë të prekura nga sëmundje si proçesionaria e pishës etj.

<u>Sipas Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Lezhë rezulton se:</u>

- Numri i mekanizmave që ushtrojnë aktivitet të shfrytëzimit të lëndës drusore është vetëm 1 (gatërr);
- Ndër sëmundjet në pyje edhe për këtë periudhë evidentohet proçesionaria e pishës e përhapur në 30 ha fond pyjor në masën 25 %;
- Sipërfaqja e përgjithëshme në erozion është 600 ha në zonën Mërqi-Kallmet-Troshan, të ekonomisë pyjore "Zadrimë". Shkaqet janë mungesa e bimësisë pyjore, zhveshja e shpateve dhe dëmtimi i pritave malore ekzistuese;
- Për vitin 2001 janë pyllëzuar me akacie objektet "Kala" 2 ha dhe "Vain" 2 ha financuar nga buxheti i shtetit me vlerë 750 mijë lek. Janë bërë punime pyjore (ndërtim prita malore, shërbime në kultura, përmirësime pyjesh etj., me vlerë 2,548,100 lekë financuar nga Njësia e Menaxhimit të Projektit të Pyjeve në pyjet komunalë të Komunave Blinisht, Kallmet, Lezhë. Është ndërtuar belvedere, stola e tavolina etj., në rezervatin natyror Kunë e Vain (ZM) me vlerë 300,000 lekë të financuar nga buxheti i shtetit (llogaria e të ardhurave).

### 3.3.2 Ulja e llojshmërisë biologjike, prishja e habitateve

Territori me emrin Kunë-Vain-Tale konsiderohej (7/7/1940) **Rezervë Gjuetije Shtetërore**, me konceptin e sotëm konsiderohet zona e parë e mbrojtur e shpallur në vendin tonë. Shkencëtarët e kanë quajtur "Oaz i Ornitologjisë së Mesdheut", "Perlë e natyrës Shqiptare, një Privilegj i saj".

Lagunat janë sistemet më produktive të botës së gjallë. Në Kunë e Vain janë

njohur 196 lloje shpendësh dhe janë cilësuar ndër vendet më të pasura të Europës për shpendët dimronjës të ujit dhe folenizues (*Ardeideve, Phalacrocorideve*). Janë evidentuar gjithashtu 277 lloje të bimëve të larta. **Çfarë vërehet?** 50 herë ka rënë numri i çifteve të shpendëve folenizues në krahasim me vitet 1951 – 53, 14 lloje të rrezikuara të faunës ndodhen në listat e konventave ndërkombëtare, pelikani kaçurrel (*Pelicanus crispus*) është larguar që në vitin 1993. 6 bimë të larta rrezikohen të zhduken etj.

E ngjashme paraqitet situata dhe në rezervatin e Borizanës. Aktualisht këto zona me sipërfaqe 3,180 ha kanë statusin rezervë natyrore e menaxhuar, Kategoria IV sipas IUCN–së. Ministria e Mjedisit po mundëson përfshirjen e lagunave Kunë e Vain ne Konventen e Ramsarit për të krijuar më shumë mundësi për mbrojtjen e zhvillimin e vlerave natyrore të tyre. Kjo pasuri e rrallë natyrore ofron mundësi të mëdha për zhvillimin e ekoturizmit dhe investimi më i madh që mund të bëhet është mbrojtja e saj. Potencialet rigjeneruese janë akoma të shprehura. Mbrojtja e biodiversitetit si komponent i rëndësishëm mjedisor duhet të konsiderohet një prioritet bazë.

**Tab. 1** *Pasqyra e numrit të llojeve të rrezikuara të takuara për Lezhën dhe të shënuara në Librin e Kuq*

| Taksonet | Lezha | Shqipëria |
|---|---|---|
| **Bimë** | | |
| Kërpurdha | | 45 |
| Bimë detare | - | 25 |
| Bimë të larta | 10 | 130 |
| **Bimë Total** | **10** | **200** |
| | | |
| **Shoqërimet Bimore** | **21** | **104** |
| | | |
| **Kafshët** | | |
| Molusqe të tokës e ujra të ëmbla | 3 | 41 |
| Molusqe detare | 18 | 46 |
| Krustace | 26 | 59 |
| Insekte | 16 | 121 |
| Ekinodermatë | 7 | 17 |
| Peshqë | 9 | 60 |
| Amfibë | 6 | 15 |
| Reptilë | 23 | 36 |
| Shpendë | 39 | 104 |
| Gjitarë | 5 | 33 |
| **Kafshë total** | **152** | **532** |
| | | |
| **BIMË + KAFSHË** | **183** | **836** |

### 3.3.3 Erozioni i tokës bujqësore dhe keqadministrimi i saj.

Përmbytjet si ato të vitit '96 deri në 4,500 ha, të '97-ës dhe nga kapërderdhja e detit e vitit të kaluar kanë përkeqësuar e dëmtuar rëndë shtresën aktive të tokës në një sipërfaqe të konsiderueshme. Po kështu kanë pësuar një erodim të plotë 3.5 ha tokë bujqësore të komunave Kolsh, Zejmen, Kallmet, Kashnjet

si dhe 13 ha fond pyjor në vitet e sipërpërmëndura. Gjithashtu dyfishimi i numrit të të imtave (dhënve e dhive) ka ndikuar në varfërimin e masës vegjetative në taracimet veçanërisht afër zonave urbane duke ndikuar ndjeshëm në erodimin e tyre ndërsa hapësira të konsiderueshme të ekonomisë pyjore të Molungut të dominuara nga shkurreta mbeten të pazëna nga blegtoria etj.

Në tokat e larta mbi projektin e rehabilitimit të sistemit ujitës e kullues llogariten 3 ton/ha/vit me 0.2 mm thellësia e lëvizjes së dherave në tokat e menaxhuara mirë ndërsa 300 ton/ha/vit (2 cm thellësia e lëvizjes së dherave) në tokat e menaxhuara keq ndërkohë që ritmi mesatar i erodimit në shkallë kombëtare është 30 ton/ha/vit.

Sipërfaqe të tëra toke bujqësore, veçanërisht ato fushoret (sidomos jugu i Lezhës dhe Bregu i Matit) janë kthyer pa asnjë studim në tokë truall.

Hyrja e detit në drejtim të tokës në zonën e Vainit ka arritur deri ne 400 m thellësi si pasojë e rritjes së erozionit detar të shkaktuara kryesisht nga ulja rreth 13 herë e aluvioneve të ngurta që sjell lumi Drin në krahasim me vitin 1939. Ky përparim i detit llogaritet afërsisht 2.5 m në vit për periudhën në fjalë.

### 3.3.4 Zhvillimi i pakontrolluar urban.

Ndërtimet e shumta të banesave e të objekteve të tjera kryesisht tregtare, rehabilitimet e mjaft banesave, si në qytetin Lezhë, Shëngjin e në disa komuna tregon potenciale të konsiderueshme për t'u zhvilluar. Por, ndërtimet pa kritere të përcaktuara urbane që një numër i konsiderueshëm nuk kanë lejë, po rëndojnë e dëmtojnë infrastrukturën dhe po zbeh mundësitë urbane të zhvillimit të qytetit në të ardhmen.

Në jug të qytetit të Lezhës, pas kanalit ujëmbledhës të Malësisë, në një kohë shumë të shkurtër toka bujqësore është mbushur me ndërtime jashtë çdo kriteri urban duke humbur të ardhmen qëndër urbane apo lagje e qytetit.

E njëjta situatë po paraqitet në Barbullojë ku më e keqja dhe në afërsi të puseve arteziane që furnizojnë qytetin më ujë (deri 10 m) ndërsa thellësia e 4 puseve që ndodhen këtu është nga 56 deri 72 m. Ka raste të ndërtimeve në sipërfaqe ku dukuria e karstit është evidente.

Sipas Ndërmarrjes së Gjelbërimit (për 6 mujorin) rezulton se sipërfaqja e gjelbërt është 100,000 $m^2$ (4.1 m për frymë të popullsisë banuese të qytetit) ndërsa ajo e zënë me lejë është 2,000 $m^2$ dhe e zënë pa lejë 4,000 $m^2$. Numri i ndërtimeve me themel është 42 dhe pa themel 100 si dhe janë ndërtuar 4 garazhe me lejë dhe 2 pa lejë.

### 3.3.5 Rritja e shkarkimeve dhe e rriskut të ndotjeve

**a. Shkarkimet në ujë**

Rritja e shkarkimeve të ujrave të zeza direkt në lumin Drin e më keq në liqenin e Knallës pa impiant trajtimi si dhe rastet e hedhjeve të mbeturinave urbane në ujra e sidomos në zonat rurale e kanë përkeqësuar cilësinë e ujrave dhe varfëruar habitatet ujore. Shkarkimet në lumin Drin dhe në detë të 19,200 litrave në 24 orë të ujrave larëse teknologjike nga 4 fabrikat e peshkut pa zbatimin e një programi monitorimi dhe kur matjet e Laboratorit të Higjenës nuk janë bindëse dhe të plota (për mungesë pajisjesh e reaktivësh) e vënë situatën nën rriskun e ndotjeve.

**b. Shkarkimet në ajër**

Qyteti i Lezhës ka të rregjistruar rreth 4,000 automjete nga të cilët 2,800-3,000 janë në qarkullim e 60 % e tyre përdorin si karburant naftën dhe janë të prodhimeve vitit 1990 si dhe një kontigjent përpara këtij viti (76-83).
Gjithashtu, shkarkime në ajër ka dhe nga aktivitetet e furrave të bukës që punojnë me solar, fabrika e tullave, si dhe rastet e djegjes abuzive të mbeturinave.

**c. Shkarkimet në tokë**

Për shkarkimet e mbeturinave urbane qyteti Lezhë rezulton:

**Tab. 2** *Pasqyra e shkarmimeve të mbeturinave urbane për Lezhën dhe Shëngjinin*

| Nr | Emërtimi | Gjithësej (ton) | Qyteti | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Lezhë | Shëngjin |
| 1 | Sasia mesatare e mbeturinave që grumbullohen çdo ditë | 24 | 22 ton | 2 ton |
| 2 | Sasia sipas përbërjes në ditë (ton) | | | |
| | a – Lëndë organike | 14.4 | 13.2 | 1.2 |
| | b – Letër | 2.88 | 2.64 | 0.24 |
| | c – Qelq | 1.68 | 1.54 | 0.14 |
| | d – Alumin, çelik | 0.024 | 0.022 | 0.002 |
| | e – Plastike | 0.111 | 0.11 | 0.001 |
| | f – Të ndryshme | 4.896 | 4. 488 | 0.408 |

### 3.3.6 Probleme të administrimit të burimeve natyrore.

a. Shfrytëzimi i kundraligjshëm i pasurive floristike e faunistike është bërë një dukuri konstante. Kësaj situate i përgjigjet shprehja anonime "Natyra ka mjaft për nevojat e gjithësejcilit por, nuk ka mjaft për lakmitë e gjithësejcilit". Biodiversiteti i zonave të mbrojtura po ulet deri në nën nivelin e zonave të lira;
b. Shfrytëzimi i zhavorreve të lumit Mat në kundërshtim me ligjin dhe pa studimet përkatëse po përkeqësojnë situatën mjedisore të shtratit të këtij lumi dhe deri në afërsi te Urës së Milotit ;
c. Shfrytëzimi i gëlqerorëve në vendet tërheqëse dhe afër zonave të ndjeshme mjedisore po humbet vlerat pejsazhiste dhe ku rrezikohet që të mos bëhet rehabilitimi (mali i Shëngjinit);
d. Shfrytëzimi në mënyrë tepër intensive i rezervave nëntokësore të ujit të pijshëm në zonën e Bregut të Matës ku uji nga puset arteziane përdoren për ujitje dhe derdhja vazhdon gjatë gjithë kohës dhe kur nuk përdoret. Puset arteziane të hapura në vitet 73–75 (35l/S) për uljen e kripshmërisë së lagunave kanë një ulje prej 70 % të kapacitetit fillestar.

### 3.3.7 Probleme të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

Nga situata e shkaktuar nga përmbytjet në datat 21-26 shtator 2002:
Si rezultat i rënies së mbi 200 mm reshje brenda një periudhe kohore të shkurtër janë shkaktuar përmbytje në 15,000 ha tokë, dëmtime në sistemin elektrik dhe në infrastrukturën rrugore. U dëmtuan argjinatura, kanale vaditës e ujëmbledhës, ujësjellësa e rrjete shpërndarës, objekte social-kulturore, u bënë të pabanueshme 160 shtëpi.

**Shkaktarë kryesorë për këto përmbytje konsiderohen:**

i. Fryrja e lumit Drin nga mbathja e shtratit, rolit të baticave dhe niveli i lartë i reshjeve. Ka ndikuar shumë në fryrjen e lumit Drin dhe thyerja e argjinaturës së lumit Gjadër, i cili ka shkarkuar ujrat në lumin Drin.
ii. Bllokimi i kanaleve kulluese nga ndërtimet e paligjëshme sidomos në zonat fushore të bregut të Matit e Shëngjinit.
iii. Dëmtime të argjinaturave mbrojtëse nga ndërtime të paligjëshme apo shfrytëzimi pa kriter i inerteve në afërsi të këtyre objekteve si rezultat i të cilave është ndikuar në devijime të shtratit të lumit Mat sidomos në zonën e Bregut të Matës.
iv. Amortizimi i hidrovoreve. Hidrovoret kanë punuar me kapacitet të ulët ose nuk kanë funksionuar.
v. Prishja e pritave malore dhe mosinvestimi në të është një nga shkaqet që kanë ndikuar në rritjen e shpejtësisë dhe sasisë së prurjeve (me inerte).

# 4. BIODIVERSITETI I QYTETI TË LEZHËS

## 4.1 Biodiversiteti në brigjet e lumit Drin (Zona që përshkon qytetin e Lezhës)

Lezha shquhet për një biodiversitet të lartë dhe peisazh të bukur. Ky biodiversitet i lartë i dedikohet faktorëve favorizues eko-gjeografik. Zona rreth qytetit të Lezhës ka patur habitate të përshtatshme për praninë e një larmie organizmash të gjalla. Bregu i lumit ka qenë i veshur me një brez të gjelbëruar nga shelgjet, plepi dhe mrina, por nuk kanë munguar kashta dhe kallami duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për folenizimin dhe qëndrimin e shpendëve. Në lumë gjendeshin rreth 20 lloje peshqish disa prej tyre me origjinë detare si: levreku, qefulli dhe ngjala. Banorët e qytetit në kohën e lirë bënin gjueti sportive të peshkut. Rosat dhe patat shtëpiake ia shtonin larminë dhe bukurinë këtij lumi, kurse peisazhi i bukur shërbente si vend qetësie, pushimi dhe argëtimi. Por, tashmë faktorë të tillë si, rritja e popullsisë, zhvillimi i bujqësisë, industrisë përpunuese, urbanizimi dhe transporti kanë sjellë efekte të forta negative në biodiversitetin dhe peisazhin e lumit Drin. Dëmtimet dhe pasojat e të cilëve mund të përmblidhen në:

- Dëmtim, varfërim dhe degradim i ekosistemeve dhe habitateve;
- Humbje dhe fragmentim të habitateve;
- Zhdukje dhe cënim i llojeve.

Që në vështrimin e parë të kësaj zone të lumit Drin të bie në sy ndryshimi i madh me të kaluarën. Kudo gjatë bregut të lumit shihen grumbuj të mëdhenj me mbeturina nga më të ndryshmet, shkarkimi i ujrave të zeza duke sjellë ndotjen e mjedisit, prishjen dhe fragmentimin e habitateve. Ndërtimet pa kriter të bëra në të dyja anët e lumit kanë sjellë prishjen e brezit të gjelbëruar që përbëhej nga shelgu, plepi e marina, erozioni ka dëmtuar brigjet, ndërsa mbeturinat e hedhura nga ndërtimet kanë mbushur shtratin e lumit. Sot nuk dëgjohen si dikur cicërimat e zogjve, nuk shihen të zhyten në ujin e këtij lumi rosat e patat.
Rritja e popullsisë, zhvillimi i ndjeshëm i ekonomisë, kanë sjellë rritjen e volumit të mbeturinave urbane të cilat asnjëherë nuk janë menaxhuar siç duhet por janë hedhur aty-këtu gjatë gjithë bregut të lumit duke formuar grumbuj të mëdhenj mbeturinash të cilat shërbejnë si burim infeksionesh për përhapjen e sëmundjeve dhe ndotjen e mjedisit që na rrethon. Duke mos u marrë sa e siç duhet me trajtimin

e mbetjeve urbane në aspektin organizativ, teknik dhe trajtimit biologjik të tyre është rritur shumë ndotja e mjedisit dhe vërehet një prezencë e madhe e $CO_2$, $CH_4$, $N_2O$.

Pakësimi i ujit të detit në shtratin e lumit, ndotjet që sjell gjatë rrjedhjes së tij, shkarkimi i 15 pikave të ujrave të zeza të qytetit pa asnjë impiant pastrimi, shkarkimet e mundëshme nga shpëlarja me reshjet e grumbujve të mbeturinave urbane kanë prishur cilësinë e ujit të lumit dhe shikohet ulja e ndjeshme e oksigjenit të tretur në ujë duke dëmtuar dhe varfëruar habitatin ujor ku është i dukshëm varfërimi i vegjetacionit ujor gjithashtu, ka një pakësim të dukshëm në lloje dhe në sasi të shpendëve dhe peshqve.

*Biodiversiteti është larmia e botës së gjallë që na rrethon mbi të cilën kemi mbështetur jetën dhe mirëqënien tonë prandaj të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm për nevojën e ruajtjes së tij.*

### 4.2 Biodiversiteti i Kodër-Marlekajt

Kodër-Marlekaj nga vetë emërtimi është një kodër e cila gjendet në veri-perëndim të qytetit të Lezhës. Kohët e fundit nga një kodër e pabanuar është kthyer në një lagje të qytetit me rreth 6,000 banorë.

Me popullimin e kësaj kodre, nga banorë të ardhur kryesisht nga zonat verilindore të Shqipërisë dhe nga fshatrat malore të rrethit të Lezhës, ndryshoi jo vetëm pamja e saj por, u dëmtuan edhe habitatet që ekzistonin. Në Kodër-Marlekaj dallohen tre habitate që janë pjesë e habitateve të para viteve 90:

- Këneta e quajtur “Këneta e Kuçedrës” e cila shtrihet në jug të kodrës dhe pranë stacionit të trenit. Vitet e fundit aty është ndërtuar fabrika e përpunimit të peshkut “EURO FISH” e cila ndikon negativisht në kënetë duke derdhur aty ujrat e pista të saj.
- Kjo kënetë e populluar kryesisht nga kallamishte (*Phragmites comunis*) gradualisht po shkon drejt zhdukjes, jo nga zhvillimi i vrullshëm i suksesionit por nga dora e njeriut, i cili po e mbush gradualisht me mbeturina inerte dhe me dhe, duke e kthyer në troje për shtëpi banimi;
- Habitati tjetër i pranishëm në këtë zonë është një pjesë e pyllit të pishave me *Pinus pinea* dhe *Pinus halepensis* të kultivuara dikur nga ndërmarrja pyjore, por sot kanë mbetur kryesisht në lartësi të kodrës, sipër zonës së banuar dhe tek-tuk ndonjë pishë e vetmuar ka mbijetuar kryesisht ne ato pika ku banorët s’kanë mundur dot t’i përdorin për qëllime të tjera, për vetë natyrën shkëmbore të territorit kodrinor;

- Kurse habitati tjetër shtrihet përgjatë një prroske dhe brigjeve më të ulëta ku dominohet nga driza (*Paliurus achuelatus*), murrizi (*Crataegus monogyna*), manaferrat (*Rubus ulmifolius*), trëndafili i egër (*Rosa canina*) etj. Nga bimët barishtore mjekësore në Kodër-Marlekaj takohen sherbela (*Salvia officinalis*), trumza (*Saturca montana*), lisna (*Thymus longicaulis*), bari i gjarpërit (*Teucrium chamaedrys*) dhe bari i majasellit (*Teucrium polium*).

Pavarësisht se mund të dallohen qartë këto habitate, ato janë të dëm-tuar e shpesh të copëtuar në pjesë të vogla duke krijuar makroklima të favorshme për vegjeta-cion ndonëse për një nu-mër të vogël shpendësh kryesisht Paseriformes.

**Tab. 3** *Pasqyra e numrit të shpendëve që gjenden në zonën Kodër-Marlekaj.*

| Sot në Marlekaj gjenden këto shpendë: |
|---|
| **pula e ujit** (*Gallinula chloropus*) e cila takohet vetëm tek “Këneta e Kucedrës” |
| **circamiu** (*Troglodytes troglodytes*) |
| **gushëkuqi** (*Troglodytes troglodytes*) |
| **dallëndyshja bishtgjërë** (*Hirundos rustica*) |
| **fikca** (*Oriolus oriolus*) |
| **gargulli** (*Sturnus vulgaris*) |
| **grizhla** (*Pica pica*) |
| **cilikoka** (*Korvus monedula*) |
| **sorra** (*Corvus cornix*) |
| **trishtili i kaltër** (*Parus caeruleus*) |
| **trumcaku** (*Paser domesticus*) |
| **zogu i borës** (*Fringilla coeleks*) |
| **gardelina** (*Carduelis carduelis*) |
| **fuga** (*Emberiza calandra*) |

Me ardhjen e banorëve bashkë me lulëzimin e ndërtimeve familjare (për banim) u ndryshua edhe përbërja floristike e kodrës sepse në vend të pishave, ferrave e drizave banorët krijuan tarraca të vogla dhe në to kultivohen perime dhe drurë frutorë të ndryshëm si qershi, kumbull, fik, hurmë, hardhi, mollë, dardhë, pjeshkë etj.

Në kultivimin familjar të këtyre bimëve ka ndikuar prania e ujit e sjellë këtu nga vetë banorët.

**Tab. 4** *Pasqyra e numrit të shpendëve që vizitojnë zonën Kodër-Marlekaj.*

| Si vizitorë të rastit ose banorë të habitateve shkurrore takohen : |
|---|
| **mullizeza** (*Turdus merula*) |
| **bufi** (*Bubo bubo*) |
| **kukuvajka** (*Athene noctua*) |
| **qyqja** (*Cuculus conarus*) |
| **skifteri** (*Acipiter nisus*) |
| **pupëza** (*Upupa epops*) |
| **qukapiku** (*Dendrocapus major*) |
| **grishlemca** (*Garrulus glandarius*) etj. |

Ndryshime ka pësuar edhe fauna sepse janë larguar gjitarët si: dhelpra (*Vulpes vulpes*), lepuri (*Lepus capensis*), macja e egër (*Felis silvestris*) etj., dhe shpendët si: mëllenja (*Turdus merula*), pupëza (*Upupa epops*), qukapiku (*Dendrocapus major*), grishlemca (*Garrulus glandarius*), pëllumbi i egër (*Columbia livia*) etj., nga banorë të zakonshëm ose popullata të medha në këtë kodër tani ata takohen vetëm si vizitorë ose s’takohen fare.

# 5. PROBLEME MJEDISORE VENDORE

**TEMATIKA:** **LEZHA DHE MJEDISI URBAN**
Urbanistika, rritja e popullsisë, zënia e truallit, etj.

**PËRSHKRIM I SHKURTËR:**
Lezha si qytet brenda vijës së verdhë është e organizuar në:
- Zonën A që përfshin nga lumi Drin në Kala e nga ish- ushqimorja në rrugën Shtraus, me shtrirje Veri-Jug 1400 m dhe Lindje-Perëndim 500m.
- Zonën B që përfshin nga ish-N. Ndërtimit dhe kodrën e Marlekajve, shtrirje Veri-Jug 600m dhe Lindje-Perëndim 800m. Këto dy zona zënë një sipërfaqe 120 ha dhe janë të rilevuara plotësisht.
Lezha është e përbërë nga 5 blloqe banimi, përkatësisht në atë të lagjes Skënderbeg, Beslidhja, Gurra, Varosh e Kodër-Marlekaj të cilat përfshihen brenda vijës së verdhë të ndërtimit në një sipërfaqe prej 125 ha.
Brenda vijës së verdhë kemi dhe zonën suburbane që shtrihet në rrugën Shtraus-ish SMT, Rruga Kallmet-fabrika e Tullave, Rruga Ura e Re-ish Fabrika e Letrës e Lagja Caraj e cila është zonë e pastudiuar dhe e parilevuar.

**Problemet e vërejtura**

- Ndërtime të paplanifikuara, që nuk respektojnë studimet (blloku A) e që dëmtojnë zonën arkeologjike (vendvarrimi i Skënderbeut, kala etj), zënë vendet publike, në vendet tërheqëse si në anë të lumit Drin e planifikuar për shëtitore si dhe e shpatit të Kalasë, që prishin ekuilibrat urban, etj;
- Asfiksimi urban në 70 % të periferisë nga pikëpamja e zënies së hapësirave për zhvillim të planifikuar për të ardhmen;
- Mungesa e vendeve të lira për parqe për qytetin, shëtitore etj;
- Mungesa e studimeve për zonën suburbane si dhe e zgjerimit të vijës së verdhë;
- Infrastruktura rrugore, kanalizimet etj., nuk i përgjigjen dhe nuk përballojnë zhvillimet urbane me banesa lokale dhe infrastrukturë e paridimensionuar;
- Zona industriale e papërcaktuar, e coptuar e që nuk respekton normat e mjedisit urban.

**TEMATIKA:** **MJEDISI URBAN DHE SHËNDETI**

Administrimi i ujrave, furnizimi me ujë të pijshëm, siguria ushqimore, mbetjet urbane, mbetjet e rrezikshme.

## PËRSHKRIM I SHKURTËR:

Me gjithë përmirësimet e bëra, rrjeti i amortizuar shpërndarës i ujit të pijshëm, i cili nuk mbulon të gjithë zonën e banuar, braktisja e ujrave të zeza në një rrjet të dëmtuar e amortizuar (pjesërisht i rehabilituar) e shkarkimi i tyre i patrajtuar në 15 pika në lumin Drin, mungesa e një administrimi të përshtatshëm të mbeturinave urbane e mbetjeve në përgjithësi, siguria ushqimore e ulët, krijojnë shpesh vatra të ndotura që ndikojnë dhe rrezikojnë shëndetin e komunitetit.

**Problemet e vërejtura**

- Uji i pijshëm në shumë raste i ndotur (treguesit fizik e bakteriologjik);
- Ujrat e zeza shkarkohen të patrajtuara në lumin Drin si dhe ka dalje të lirë në mjaft raste në mjediset e jashtme të pallateve;
- Lumi Drin i ndotur nga shkarkimet e ujrave të zeza si dhe mbetjeve të ndryshme urbane dhe rritja e pezullive nga prurjet në rast reshjesh (sidomos nga efektet e erozionit të zhvilluar);
- Mjedisi tregtar i produkteve blegtorale, bulmetrave etj., rrezikon ndotjen e ushqimeve;
- Vatra të ndotura nga mbeturinat urbane veçanërisht në zonën suburbane dhe që nuk përfshihen në zonën e pastrimit. Mjedisi urban nën rrezikun e ndotjeve nga mbeturinat spitalore (mbetjet e rrezikshme). Ndikimet ndotëse të sheshit të grumbullimit të mbeturinave urbane në zonën përreth;
- Rritja e rriskut të ndotjes së ajrit nga rritja e trafikut etj., (si dhe tokës e ujit) dhe mungesa e sistemeve të monitorimit.

**TEMATIKA:** **MBROJTJA E NATYRËS**

Toka, tjetërsimi i brigjeve të Drinit, erozioni, shpyllëzimi, gjelbërimi, biodiversiteti, ekosistemet kritike dhe rreziku.

## PËRSHKRIM I SHKURTËR:

I vendosur në luginën e lumit Drin, qyteti i Lezhës është zhvilluar në harmoni me vlerat e natyrës, por që vitet e fundit janë dëmtuar shumë. Brigjet dhe vetë lumi Drin, shpati i Kalasë përbënin habitate potenciale për biodiversitetin e pasur që mbartnin. Në lumin Drin ka qenë i njohur peshku blin (*Acipenser sturio L*), i cili aktualisht konsiderohet i zhdukur. Dëmtimet në shpatin e Kalasë të asociacionit të shegës së egër ( *Punicetum granatae*) etj., ka dëmtuar rëndë cilësitë natyrore të ekosistemit. Përkeqësimi i masës bimore të këtij shpati ka bërë që në kohë reshjesh të zbresin me prurjet, dhjetra ton inerte të cilat shpesh kanë paralizuar pjesë të infrastrukturës urbane.

**<u>Problemet e vërejtura</u>**

- Prishja e habitateve dhe varfërimi i biodiversitetit (Lumi Drin e brigjet, shpati i Kalasë, mali Skënderbeg , L. Kodër-Marlekaj etj.);
- Zhvillimi i erozionit në shpatin e Kalasë, Malin e Shelbumit, është favorizuar nga dëmtimi i masës bimore të tyre;
- Dëmtimet e habitateve artificiale e natyrale brenda zonës së urbanizuar të qytetit;
- Prishja e koridoreve ekologjike Drin – Shpati i Kalasë etj;
- Prishja e habitateve në zonat suburbane dhe varfërimi i biodiversitetit.



**TEMATIKA:** **SHËRBIMET URBANE**
Burimet e energjisë. Informacioni, aspekti tregtar, transporti urban

## PËRSHKRIM I SHKURTËR:

Merkatizimet në të dy anët e rrugëve si frut i ekonomisë së tregut kanë punësuar rreth 60% të të gjithë subjekteve që ushtrojnë aktivitet në këtë qytet duke ndikuar në ngritjen e nivelit social- ekonomik të komunitetit, por dhe duke i krijuar një presion në rritje mjedisit urban të këtij qyteti.
Katër pika shpërndajnë gazin për komunitetin veç dhjetrave që tregtojnë bombolat e vogla duke e futur në çdo shtëpi këtë burim energjie. Ndërsa energjia elektrike zë një vënd të rëndësishëm përdorimi, por shpërndarja bëhët me një rrjet ajror të pasigurtë dhe duke rrezikuar qytetarët si dhe me transformatorë elektrik në blloqe banimi që nuk përballojnë ngarkesat.
2,800 automjete janë në qarkullim, por mungesa e dy urave mbi lumin Drin, mungesa e rrugëve me një kalim, mungesa ose dëmtimi i infrastrukturës rrugore, mungesa e një shërbimi publik të disiplinuar ndërurban apo dhe brenda hapësirës urbane të qytetit, sjellin konfuzion në këtë lloj shërbimi duke ndikuar negativisht në mjedisin urban.
Centrali dixhital "SIEMENS" me kapacitet 300 numra telefonik, instalimi i 15 kartofonave të konfiguruar mirë me mjedisin urban kanë ndikuar në plotësimin e këtij shërbimi.

**Problemet e vërejtura**

- Mungesa e përdorimit të burimeve të tjera të energjisë (era, dielli) dhe mungesa rrugëve të tjera që ulin koston e gazit si burim më i përshtashëm aktual energjie;
- Rritja e kostos nga përdorimi energjisë elektrike dhe ndikimet direkte e indirekte në mjedis;
- Ndikimet në mjedisin urban nga rrjeti i amortizuar ajror elektrik e rreziqet për komunitetin;
- Transporti publik interurban dhe brenda hapësirës urbane të qytetit i papërshtatshëm;
- Pamjaftueshmëria e parkingjeve, vendqëndrimeve, mungesa e rrugëve me një kalim për automjetet, mungesa e dy urave në lumin Drin etj., kanë ndikuar në rritjen e konfuzionit dhe ngarkesës në mjedisin urban.

**TEMATIKA:** **AKTIVITETI SOCIAL-KULTUROR**
Aktiviteti kulturor e artistik, turizmi, sporti, objektet turistike, guidat, agjencitë, muzetë, bibliotekat etj.

## PËRSHKRIM I SHKURTËR:

Qyteti antik i Lisit përbën një fond të pasur objektesh arkeologjike pjesë e mjedisit të sotëm urban të qytetit Lezhë si dhe objektet e tjera Kalaja, vendvarrimi i Skënderbeut etj. Vazhdimësia e pasur e jetës social-kulturore e sportive e komuniteti nuk ka gjetur akoma mjedisin e përshtatshëm urban e që të respektojë e zhvillojë atë natyror.

**Problemet e vërejtura**

- Papërshtashmëria midis objekteve kulturore e sportive me mjedisin urban të qytetit, mosrespektimi i mjedisit natyror ose i zhvillimit të tyre;
- Objektet arkeologjike të pasistemuara dhe me mjedise të gjelbërta të papërshtatshme. Mungesa e menaxhimit, (mungesa e infrastrukturës për menaxhimin e tyre);
- Degradimi i elementeve të objekteve historike të lagjes së vjetër Varosh (shtëpitë monument kulture, rrugëve me kalldrëm, etj), si dhe i muzeve etnografikë e historikë, mungesa e harmonizimit dhe respektimit të natyrës përreth;
- Mosmenaxhimi i objektit të kalasë së Lezhës për turizëm, mungesa e rehabilitimeve e rikonstruksioneve, dëmtimet e objektit (ndikime direkte e indirekte në mjedis);
- Mungesa e akseseve për aktivitetet sportive e kulturore në natyrë dhe për pasojë dhe mosmarrja nën kujdes e rehabilitim të objekteve natyrore, për ruajtjen e përmirësimin e tyre.



**TEMATIKA:** **QEVERISJA**

Mënyrat e qeverisjes vendore, gjenerimi i të ardhurave (taksat), varfëria dhe ekonomia urbane.

## PËRSHKRIM I SHKURTËR:

Me shëndërrimet demokratike, në vitin 1992 qyteti i Lezhës u organizua në Bashki dhe aktualisht në stafin e kësaj strukture janë të punësuar 44 vetë.
Lezha është qëndra më e rëndësishme administrative e Qarkut me të njëjtin emër në të cilin ndodhen godina e Qarkut, Prefekturës dhe Bashkisë si dhe e institucioneve që ushtrojnë aktivitet në këtë njësi.

Forca aktive për punë janë rreth 12,000 vetë nga këto në emigracion rreth 300 vetë. Me koefiçent papunësie 16.5 % , janë të rregjistruar si të papunë rreth 3,200 banorë. Në qytetin e Lezhës ushtrojnë aktivitetin e tyre privat rreth 6,000 subjekte ku mbi 60% kanë aktivitet tregtar. Janë të punësuar 2,812 punonjës (në sektorin shtetëror 1,582 dhe në atë privat 1,230).

**<u>Problemet e vërejtura</u>**

- Mungesa e organeve përgjegjëse ligjore për hartimin e strategjive të zhvillimit;
- Administrimi i mangët ligjor i territorit urban, (njohja e kthimi i pronave brenda hapësirave urbane);
- Mungesa e inspektoriatit urban për territorin e bashkisë;
- Prishjet e mjedisit urban dhe mungesa e policisë bashkiake për ndërhyrjen e menjëherëshme;
- Menaxhimi i mangët i mjedisit urban e i aktiviteteve të tjera për të mbështetur zhvillimet që respektojnë mjedisin, që rehabilitojnë e përmirësojnë atë;
- Ndërgjegjësimi i pakët i komunitetit për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të përgjegjësive ligjore në këtë drejtim. Mungesa e rrjetit informativ e ndërgjegjësues për mjedisin.

# 6. VEPRIMET MJEDISORE PRIORITARE

## TEMATIKA: LEZHA DHE MJEDISI URBAN

Urbanistika, rritja e popullsisë, zënia e truallit, etj.

**1. Realizimi i studimit urbainstik për lagjen Kodër-Marlekaj.**

*Përshkrimi:*

Realizimi i plotë i studimit mbi bazën e azhornimit të gjëndjes. Zgjidhjet e plota në studim të infrastrukturës rrugore, kanalizimeve, telekomunikacionit, elektrikut, vendgrumbullimet e mbeturinave, si dhe obejktet shkolla, kopësht, park etj.

**2. Realizimi i studimeve (pjesore) për zonat A e B ne kuadrin e riazhornimit të plotë të situatës. Realizmi i studimeve**

*Përshkrimi:*

- Kryerja e studimit urbanistik për zonën arkelogjik caktimi i zonave të "mbrojtura urbane".
- Studimi për shëtitore në të dy anët e lumit Drin.
- Ristudim i plotë i rrjetit të transportit, zgjidhja e unazës, urat etj.
- Studimi dhe realizimi i projekteve për rrjetin e kanalizimeve.

**3. Miratimi i zonës C si vijë e verdhë.**

Realizimi i studimit urbanistik për zonën C (në jug të rrugës Shtraus).

*Përshkrimi:*

Studimi urbanistik me të gjithë elementet, harmonizimi me pjesën tjetër të qytetit dhe zgjidhje për zhvillimet perspektive në këtë zonë.

**4. Studimi dhe përcaktimi i vendeve ose teknologjive për administrimin e mbetjeve, zonën e zhvillimit industrial.**

*Përshkrimi:*

- Caktimi i vendeve për hedhjen e mbetjeve të ndërtimit e bujqësore.
- Vend për depozitimin e mbeturinave industriale e teknologjive të trajtimit.
- Studim për administrimin e mbeturinave spitalore.
- Caktimi i vendeve për varrezë automjetesh.
- Zonimi për zhvillimin industrial.

**5. Kryerja e studimit urbanistik e përcaktimi i kritereve të zhvillimit për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të trashëguara si dhe krijimi i mundësive për studime në zhvillimin e turizmit.**

*Përshkrimi:*

- Përcaktimi i kritereve të ndërtimit, respektimi i arkitekturës në përshtatje me vlerat e trashëguara (fasadat e mureve, çatitë, dritaret, rrugët me kalldrëm, portat, kopshtet etj).
- Mbrojtja dhe rikonstruksioni i shtëpive muze.
- Zdhidhjet e infrastrukturës.

**6. Studimi dhe përcaktimi i zonës për zhvillime industriale perspektive.**

*Përshkrimi :*

- Përcaktimi i zonës për vendosjen e objekteve industriale në perspektivë.

## TEMATIKA: MJEDISI URBAN DHE SHËNDETI

Administrimi i ujrave, furnizimi me ujë të pijshëm, siguria ushqimore, mbetjet urbane, mbetjet e rrezikshme

**1. Rikonstruksioni i rrejtit të kanalizimeve për zonën A e B dhe ndërtime segmentesh e magjistralesh të reja të përshtatshme (rrjete të reja nga studimet pjesore urbane).**

*Pershkrimi:*

Studimet, rikonstruksionet dhe ndërtimet e reja të rrjetit kanë të bëjnë më shkarkimin vetëm në një pikë të ujrave të zeza (poshtë qytetit, lumi Drin), rikonstruksioni i stacionit të vjetër të pompave dhe ndërtimi i një stacioni të ri (mbi bibliotekë).

**2. Studimi, e aplikimi i projektit të impiantit të trajtimit të ujrave të zeza (nr 1) për qytetin e Lezhës.**

Kreyrja e një plan veprimi për eleminimin e 12 pikave të shkarkimit që nuk arrijnë tek stacioni i pompimit.

*Përshkrimi:*

Ndërtimi i një impianti trajtimi në anë të lumit Drin tek ish-sektori qendër i NB-së.

**3. Studimi, e aplikimi i projektit të impiantit të trajtimit të ujrave të zeza (nr 2) për qytetin e Lezhës**

*Përshkrimi:*

Ndërtimi i një impianti trajtimi në anë të lumit Drin në zonën Ishull-Shëngjin.

**4. Përmirësimi i krejt sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.**

*Përshkrimi:*

- Krijimi i degëzimeve të reja për blloqe të reja e rikonstruksioni i rrjetit të vjetër.
- Shërbime në depo, klorinimi i rregullt, rritja e numrit të pikave të marrjes së mostrave për analizë.
- Zgjidhja teknike për realizimin e klorinimit për degëzimin për lagjen Gurra.

**5. Përcaktimi, ngritja e funksionimi efektiv i sistemit të largimit të mbeturinave urbane. Hartimi i një plani veprimi e zbatimi i tij.**

*Përshkrimi:*

- Përcaktimi i pikave, kohës, frekuencës, llojit të automjetit, për evadimin e mbeturinave dhe gjetja e burimeve financiare për këtë qëllim.
- Caktimi i ditëve për largimin e objekteve të ndryshme të vjetëruara nga banesat të nxjerra si mbetje.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit për mbajtjen pastër të qytetit dhe aplikimi gjobave.

**6. Përfundimi i fushës së mbeturinave dhe paralelisht i të gjithë sistemit të largimit të mbeturinave**

*Përshkrimi:*

- Kërkohet përfundimi i fushës së mbeturinave nga sipërmarrësit pasi është përfunduar hapja e gropës si dhe kërkohet sipas projektit vetëm një muaj kohë punime për këtë qëllim.
- Paralelisht kërkohet realizimi i një plan veprimi për ndërgjegjësimin e komunitetit.
- Krijimi i mundësive për zbatimin e teknologjive të reja dhe inisiativat ricikluese si dhe për prodhimin e biogazit nga fusha e mbeturinave.

**7. Rehabilitimi i vatrave të ndotura nga shkarkimet e mbetjeve të ndryshme.**

*Përshkrimi:*

- Largimi i mbeturinave nga vatrat e ndotura në të dy anët e lumit Drin, në lagjen Xhenjo, L. ish SMT, kanalizimet periferike.
- Caktimi i vendit për varreza të automjeteve.

**8. Zbatimi dhe mundësimi i teknologjive e aktiviteteve ricikluese të mbetjeve.**

*Përshkrimi:*

- Mundësimi i riciklimit të qelqit, letrës, metaleve etj.
- Përgatitja dhe zbatimi i një plan veprimi për këtë qëllim.

## TEMATIKA: MBROJTJA E NATYRËS

Toka, tjetërsimi i brigjeve të Drinit, erozioni, shpyllëzimi, gjelbërimi, biodiversiteti, ekosistemet kritike dhe rreziku.

**1. Restaurimi dhe përmirësimi i habitatit dhe biodiversitetit në të dy anët e lumit Drin.**

*Përshkrimi:*

- Kryerja e studimit për zonën e "mbrojtur nga ndërtimet" dhe për zhvillimin e habitatit, restaurimi me mbjellje dhe harmonizimi me shëtitoren e objektet e tjera urbane. Përcaktimi i bimësisë dhe biodiversitetit që vendoset.
- Përgatitja dhe zhvillimi i planit të veprimit për këtë qëllim.

**2. Pyllëzime të shpatit të kodrës së Kalasë.**

**- Realizimi i një rrjeti kanalizimesh për disiplinimin e ujrave.**

**- Ndalimet e kullotjes**

*Përshkrimi:*

- Pyllëzime në faqen jugore e perëndimore të shpatit të kodrës së kalasë, përcaktimi i vendeve të përshtatshme, ruajtja e tipareve natyrore të pejsazhit.
- Ndërtimi i një rrjeti ujëmbledhës efiçent në të dy anët e përroskës tek spitali si dhe po mbi këtë shpat mbi urën e vjetër.
- Hartimi i një plan veprimi për ndalimin e kullotjes, ndalimin e ndërtimeve të reja që dëmtojnë brezin vegjetativ dhe pejsazhin.

**3. Përmirësimi i brezit të gjelbert nëpërmjet marrjes së një sërë masash sipas një plani veprimi.**

*Përshkrimi:*

- Përgatitja dhe zabtimi i një plan veprimi për ndalimin e kullotjes në zonën urbane e suburbane - heqja e bagëtive.
- Monitorimi i gjendjes së pyjeve, inventarizimi dhe mbrojtja e drurëve pyjor.
- Përcaktimi i zonave të gjelbërta që nuk do të preken nga ndërtimet.
- Vënia në efiçencë e sistemit të gjobave.

**4. Pyllëzime të zonës "brinjët e kalasë" ose kurora e gjelbërt e shpatit të kodrës së Kalasë 30 ha.**

**- Ndalimi i kullotjes**

*Përshkrimi:*

- Pyllëzime në faqen jugore e perëndimore të shpatit të kodrës së kalasë, (kurora e Lezhës) përcaktimi i vendeve të përshtatshme, ruajtja e tipareve natyrore të pejsazhit.
- Hartimi i një plan veprimi për ndalimin e kullotjes, ndalimin e ndërtimve të reja që dëmtojnë brezin vegjetativ dhe pejsazhin.

**5. Restaurimi dhe përmirësimi i gjelbërimit të qytetit në të gjithë elemetet urbanë të tij.**

*Përshkrimi:*

Restaurimi i të gjitha zonave të gjelbërura që janë dëmtuar, rrethimi i tyre, ndërtimi i rrugëve dhe pengesave për të mos kaluar makinat, zbatimi i një plan veprimi për ndërgjegjësimin e qytetarëve.



**TEMATIKA:** **SHËRBIMET URBANE**

Burimet e energjisë. Informacioni, aspekti tregtar, transporti urban

**1. Realizimi dhe zbatimi i një sistemi shpërndarës elektrik kabllor nëntokësor paralel me studimet e tjera për të gjithë qytetin.**

*Përshkrimi:*

- Realizimi i studimit dhe zbatimi i projektit për rrjetin.
- Plan veprimi për marrjen e masave për mbrojtjen nga rreziku nga rrjeti i amortizuar, kabinat e dëmtuara, ndërhyrjet e kundërligjëshme etj.

**2. Plan veprimi për gjetjen e përdorimin e burimeve të energjisë e miradministrimin e saj duke minimizuar impaktin në mjedis.**

*Përshkrimi:*

- Mundësimi i nismave të të gjitha llojeve që ofrojnë gazin si burim energjie si dhe energjinë diellore.
- Përdorimi i rrjeteve qëndrore të furnizimit më gaz.
- Marrja e masave për heqjen e plotë të përdorimit të drurit për ngrohje e gatim.

**3. Zgjerimi i rrjetit kabllor me shtylla druri.**

*Përshkrimi:*

Zgjerim i rrjetit telefonik kabllor me shtylla druri bëhet në kushtet e mungesës së studimeve dhe elementëve të tjerë të infrastrukturës.

**4. Zgjerimi i rrjetit telefonik në qytetin e Lezhës me kabllo nëntokësorë.**

*Përshkrimi:*

Zgjerimi bëhet me kanal 70x40 me pusetë në zonën DP.

**5. Ndërtimi dhe shpërndarja e kabinave elektrike sipas kushteve teknike.**

*Përshkrimi:*

Studimi i ngarkesave në transformatorët e kabinave në lagje, bllok banesazh etj., dhe rinovimi i tyre.



**6. Përdorimi në masë si burim energjie i gazit të lëngët.**

*Përshkrimi:*

Promovimi i sistemeve lehtësuese e nxitja e aktiviteteve që bëjnë furnizimin me gaz të lëngët çon në uljen e përdorimit të energjisë elktrike.

**TEMATIKA:** **AKTIVITETI SOCIAL-KULTUROR**
Aktiviteti kulturor e artistik, turizmi, sporti, objektet turistike, guidat, agjencitë, muzetë, biblotekat etj.

**1. Plan veprimi për restaurimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e fondit arkeologjik, objekteve me rëndësi historike.**

*Përshkrimi:*

- Identifikimi i zonave arkeologjike që duhet të mbrohen dhe marrja e masave për këtë qëllim.
- Ndërtimi i infrastrukturës për mundësimin e menaxhimit të tyre, promovimi i guidave agjencive etj.

**2. Prishja e ndërtimeve pa leje dhe sistemimi i zonës me objekte arkeologjike.**

*Përshkrimi:*

Prishja e ndërtimeve të kësaj zone, eleminimi i mbetjeve dhe sistemimi i mjedisit. Përcaktimi i kufinjve të zonës dhe marrja e masave mbrojtëse.

**3. Realizimi i projekt-ndërhyrjes për restaurimin dhe zhvillimin e vlerave historiko-natyrore si dhe harmonizimi midis tyre.**

*Përshkrimi:*

Realizim projekti për gjelbërimit e vendvarrimit të Skënderbeut, Kalasë, dhe sheshit tek muret Ilire (shpati i Kalasë).

**4. Restaurimi i objekteve të dëmtuara që rrezikojn dëmtimin e metëjshëm të tyre.**

*Përshkrimi:*

Restaurimi i mureve të Kalasë, i portës, mureve rrethuese etj.

**5. Kryerja e studimit, zonimi dhe krijimi i mundësive për përfitimin e zonave të gjelbërta sportive.**

*Përshkrimi:*

Kryerja e studimit, zonimi dhe krijimi i mundësive për përfitimin e zonave të gjelbërta sportive, mbi kishën e Dom Lleshit, poshtë rrugës Shtraus, Grylkë Zezë.

## TEMATIKA: QEVERISJA

Mënyrat e qeverisjes vendore, gjenerimi i të ardhurave (taksat), varfëria dhe ekonomia urbane.

**1. Ngritja e Bordit Këshillimor pranë Kryetarit të Bashkisë.**

*Përshkrimi:*

Ky Bord të përbëhet nga 9 – 13 anëtarë, nga specialistë: inxhinierë, ekonomistë, biologë, mjekë, punonjës të sektorit të mjedisit, biznesmenë e të zgjedhur vendorë.

**2. Ngritja e një seksioni pranë Bashkisë për zhvillimin e qëndrueshëm.**

*Përshkrimi:*

Ky seksion të përbëhet nga 3-5 vetë, specialistë në këto fusha:
Biologji, inxhinieri, ekonomi etj.

**3. Ngritja e policisë bashkiake.**

*Përshkrimi:*

Për ndërhyrje në rastet e dëmtimeve të mjedisit urban lind si domosdoshmëri ngritja e policisë bashkiake në përbërje 5 veta, e cila të kryejë edhe detyra të tjera në vartësi të bashkisë.

**4. Veprime të përbashkëta të organeve të tjera policore (P.Pyjore, P. Ndërtimit, P. Rendit).**

*Përshkrimi:*

Sigurimi i bashkëveprimeve në mes organeve policore për të realizuar ndërhyrjen e menjëhershme ndaj dëmtuesve kundravajtës.

**5. Kulifikimi nëpërmjet trajnimeve.**

*Përshkrimi:*

Trajnim i administratës nëpërmjet seminareve për njohjen e legjislacionit mjedisor dhe situatës mjedisore. E njëjta gjë të bëhet me të zgjedhurit vendorë.

**6. Kualifikimi nëpërmjet shkëmbimit të përvojës me njësitë homologe brenda dhe jashtë shtetit.**

*Përshkrimi:*

Grupi i përbërë nga të zgjedhurit vendorë dhe përfaqësues të administratës të organizojë aktivitete shkëmbimi përvoje me njësitë homologe.

**7. Nxjerrja e një organi periodik shtypi.**

*Përshkrimi:*

Botimi i një gazete 4 faqëshe mjedisore ku të trajtohen probleme të mjedisit e të ndërgjegjësohet komuniteti në lidhje me to.

**8. Ndërgjegjësimi nëpërmjet rubrikave në TV lokal, posterave etj.**

*Përshkrimi:*

Krahas posterave dhe spoteve televizive të organizohen periodikisht emisione problemore për mjedisin.



# PLANI I



# VEPRIMIT



| Tematika | Problemi | Aktiviteti | Prioriteti (1-3)/ Afati kohor | Burimet financiare/ Përgjegjësia | Efekti |
|---|---|---|---|---|---|
| **LEZHA DHE MJEDISI URBAN**<br>Urbanistika, rritja e popullsisë, zënia e truallit, etj. | **Problemi 1**<br><br>Zhvillim urban i pakontrolluar, L. Kodër-Marlekaj.<br><br>*Përshkrimi:*<br>L. Kodër-Marlekaj, 5,000 banorë, 48 ha (zona B) po zhvillohet pa studime urbanistike megjithëse zona është përfshirë në vijën e verdhë me mangësi të mëdha në infrastrukturë dhe që pengon perspektivën urbane të saj. | Realizimi i studimit urbainstik për lagjen Kodër-Marlekaj.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Realizimi i plotë i studimit mbi bazën e azhornimit të gjëndjes. Zgjidhjet e plota në studim të infrastrukturës rrugore, kanalizimeve, telekomunikacionit, elektrikut, vendgrumbullimet e mbeturinave, si dhe obejktet shkolla, kopësht, park etj. | **1**<br><br>Afat shkurtër | Bashkia (zyra e urbanistikës)<br><br>Donatorët<br><br>Instituti i Studimeve Urbanistike | Përmirësohet zhvillimi urban në këtë pjesë të qytetit dhe favorizohet perspektiva.<br><br>Eleminohen ndotjet e ndryshme urbane. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 2**<br><br>Mungesa në infrastrukturë dhe papërshtatshmëri të saj me objektet e tjera, mosrespektim i kritereve ligjore urbane për zonën A e B (dy anët e lumit Drin).<br><br>*Përshkrimi:*<br>Për zonën A e B vërehet:<br>- Mungesa e parqeve, shëtitoreve për të gjitha lagjet.<br>-Degradime në zonën arkeologjike nga ndërtimet pa leje, dëmtime të objekteve, mosmenaxhimi i tyre.<br>- Rrjeti i transportit nuk përballon nevojat - jo efiçent - mungesa e parkingjeve. Probleme me stacionet për lidhjet interubane, mosfunksionimi i unisenseve, ndërtimi i unazës dhe ndërtimi i urave (ura e cenit dhe ura e vjetër ) etj. | Realizimi i studimeve (pjesore) për zonat A e B ne kuadrin e riazhornimit të plotë të situatës.<br>Realizmi i studimeve<br><br>*Përshkrimi:*<br>- Kryerja e studimit urbanistik për zonën arkelogjik caktimi i zonave të "mbrojtura urbane".<br>- Studimi për shëtitore në të dy anët e lumit Drin.<br>- Ristudim i plotë i rrjetit të transportit, zgjidhja e unazës, urat etj.<br>- Studimi dhe realizimi i projekteve për rrjetin e kanalizimeve. | **2**<br><br>Afat mesëm | Bashkia<br>(zyra e urbanistikës)<br><br>Donatorët<br><br>Grup studimi | Disiplinohet zhvillimi i mëtejshëm i kësaj zonë urbane duke respektuar mjedisin.<br><br>Përmirësohet dhe vihet në efiçencë infrastruktura.<br><br>Përmirësohet higjena e qytetit dhe vetë cilësia i jetës së banorëve. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 3**<br><br>Mungesa e studimeve për zhvillimin perspektiv urban. Zona C.<br><br>*<u>Përshkrimi:</u>*<br>Është kërkuar zgjerimi i vijës së verdhë në jug të rrugës Shtraus (zona C) dhe janë bërë shumë ndërtime pa kriter në këtë zonë - mungesa e infrastrukturës – mos-harmonizim me qytetin e lidhjeve rrugore të përshtatshme | Miratimi i zonës C si vijë e verdhë.<br>Realizimi i studimit urbanistik për zonën C (në jug të rrugës Shtraus).<br><br>*<u>Përshkrimi:</u>*<br>Studimi urbanistik me të gjithë elementet, harmonizimi me pjesën tjetër të qytetit dhe zgjidhje për zhvillimet perspektive në këtë zonë. | **2**<br><br>Afat shkurtër | Bashkia<br>(zyra e urbanistikës dhe KRRT-ja)<br><br>Donatorët<br><br>Instituti i Studimeve Urbanistike | Hapet perspektiva e zhvillimit urban për Bashkinë Lezhë.<br><br>Pengohet zhvillimi urban i pakontrolluar në këtë zonë e për pasojë ulet kostoja për investitorët. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 4**<br><br>Mungesa e shesheve për depozitimet e mbetjeve të ndryshme (jo urbane, industriale, bujqësore, spitalore serviseve etj).<br><br>*Përshkrimi:*<br>Mungesa e shesheve të depozitimit të mbetjeve spitalore, industriale, të ndërtimit, bujqësore, varrezave të makinave.<br>Ka shkarkime abuzive nga subjekte të ndryshme duke degraduar mjedisin natyror etj. | Studimi dhe përcaktimi i vendeve ose teknologjive për administrimin e mbetjeve, zonën e zhvillimit industrial.<br><br>*Përshkrimi:*<br>- Caktimi i vendeve për hedhjen e mbetjeve të ndërtimit e bujqësore.<br>- Vend për depozitimin e mbeturinave industriale e teknologjive të trajtimit.<br>- Studim për administrimin e mbeturinave spitalore.<br>- Caktimi i vendeve për varrezë automjetesh.<br>- Zonimi për zhvillimin industrial. | **2**<br><br>Afat mesëm | Bashkia<br>(zyra e urbanistikës)<br><br>ARM-ja<br><br>Donatorët<br><br>Subjekte studimore urbanistike | Shëndoshja e situatës mjedisore të krejt bashkisë e për pasojë e cilësisë si dhe standartit të jetesës |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 5**<br><br>Dëmtimi i vlerave urbane, arkeologjike e për pasojë dhe të vlerave kulturore e historike të lagjes se vjetër Varosh.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Lagja e vjetër Varosh ka trashëguar karakteristika të veçanta urbane, arkeologjike dhe historike të cilat po dëmtohen dhe rrezikohen nga mosmarrja në mbrojtje dhe nga ndërhyrjet për ndërtime të reja etj. | Kryerja e studimit urbanistik e përcaktimi i kritereve të zhvillimit për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të trashëguara si dhe krijimi i mundësive për studime në zhvillimin e turizmit.<br><br>*Përshkrimi:*<br>- Përcaktimi i kritereve të ndërtimit, respektimi i arkitekturës në përshtatje me vlerat e trashëguara (fasadat e mureve, çatitë, dritaret, rrugët me kalldrëm, portat, kopshtet etj).<br>- Mbrojtja dhe rikonstruksioni i shtëpive muze.<br>- Zdhidhjet e infrastrukturës. | **3**<br><br>Afat mesëm | Bashkia<br>(zyra e urbanistikës)<br><br>Donatorët<br><br>Instituti i Monumenteve të Kulturës | Mbrohen dhe zhvillohen vlerat si qendër urbane e Varoshit (lagja më e vjetër e bashkisë), vlerat arkeologjike, kulturore dhe historike.<br>Përmirësohet pejsazhi.<br><br>Krijohet mundësia e zhvillimit të turizmit. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 6**<br><br>Mungesa e përcaktimit të zonës industriale të zhvillimit.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Objektet industriale të zhvillimit janë të shpërndara në mënyrë të papërshtatshme dhe në dëm të zhvillimit urban si dhe të perspektivës të vetë subjekteve që ushtrojnë aktivitete në këto objekte. (F. e përpunimit të peshkut EUROFISH, fabrika e miellit, f. e Tullave etj). | Studimi dhe përcaktimi i zonës për zhvillime industriale perspektive.<br><br>*Përshkrimi :*<br>- Përcaktimi i zonës për vendosjen e objekteve industriale në perspektivë. | **1**<br><br>Afat shkurtër | Bashkia<br>(zyra e urbanistikës)<br><br>ARM-ja<br><br>Donatorët<br><br>Subjekte studimore urbanistike | Sigurohet zhvillim i qëndrueshëm perspektiv, zbuten ndikimet në mjedis. |

| Tematika | Problemi | Aktiviteti | Prioriteti (1-3) Afati kohor | Burimet financiare/ Përgjegjësia | Efekti |
|---|---|---|---|---|---|
| **MJEDISI URBAN DHE SHËNDETI**<br>Administrimi i ujrave, furnizimi me ujë të pijshëm, siguria ushqimore, mbetjet urbane, mbetjet e rrezikshme | **Problemi 1**<br><br>Ndotje të mjedisit urban (tokë ujë) nga ujrat e zeza. Rjeti i amortizuar dhe i dëmtuar i ujrave të zeza.<br><br>*Përshkrimi:*<br>2 pika shkarkimi të ujrave të zeza të patrajtuara në lumin Drin. Dalje në sipërfaqe e ujrave të zeza (në vende të veçanta të lagjeve Gurra, L. Varosh (spitalit), L. Skënderbeg, etj). | Rikonstruksioni i rrejtit të kanalizimeve për zonën A e B dhe ndërtime segmentesh e magjistralesh të reja të përshtatshme (rrjete të reja nga studimet pjesore urbane).<br><br>*Përshkrimi:*<br>Studimet, rikonstruksionet dhe ndërtimet e reja të rrjetit kanë të bëjnë më shkarkimin vetëm në një pikë të ujrave të zeza (poshtë qytetit, lumi Drin), rikonstruksioni i stacionit të vjetër të pompave dhe ndërtimi i një stacioni të ri (mbi bibliotekë). | **1**<br><br>Afat mesëm | Bashkia<br><br>Drejtoria e Ujësjellës - Kanalizimeve<br><br>Donatorët | Restaurohet rrjeti i kanalizimeve dhe vihet në efiçencë.<br><br>Ndalohet ndotja e mjedisit nga këto shkarkime. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 2**<br><br>Shkarkimi i ujrave të zeza në lumin Drin dhe ndotja e tij.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Ka 12 pika shkarkimi të ujrave të zeza të patrajtuara në lumin Drin si dhe shkarkimet e tjera të shtëpive të veçuara në të dy anët e lumit Drin. | 1. Studimi, e aplikimi i projektit të impiantit të trajtimit të ujrave të zeza (nr 1) për qytetin e Lezhës.<br>Kreyrja e një plan veprimi për eleminimin e 12 pikave të shkarkimit që nuk arrijnë tek stacioni i pompimit.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Ndërtimi i një impianti trajtimi në anë të lumit Drin tek ish-sektori qendër i NB-së. | **1**<br><br>Afat mesëm | Bashkia<br><br>Grupi i studimit<br><br>Drejtoria e Ujësjellës - Kanalizimeve<br><br>Donatorët | Ndërtohet impianti i trajtimit të ujrave të zeza dhe eleminohen ndotjet nga shkarkimet e ujrave të zeza për qytetin. |
| | | 2. Studimi, e aplikimi i projektit të impiantit të trajtimit të ujrave të zeza (nr 2) për qytetin e Lezhës<br><br>*Përshkrimi:*<br>Ndërtimi i një impianti trajtimi në anë të lumit Drin në zonën Ishull- | **1**<br><br>Afat gjatë | Bashkia<br><br>Grupi i studimit<br><br>Drejtoria e Ujësjellës - Kanalizimeve<br><br>Donatorët | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 3**<br><br>Uji i pijshëm i qytetit Lezhë në shumë raste i ndotur.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Analizat tregojnë në shumë raste ndotje bakteriologjike dhe me mungesë klori. Puset e Barbullojës që furniozojnë qytetin me ujë të pijshëm nuk funksionojnë me breza të rregullt mbrojtës. Mungojnë pajisjet klorinuese për degëzimin e rrjetit të ujti që furnizon L. Gurra (spitalit). Sistemi shpërndarës në mjaft segmente i amortizuar e më shumë ndërhyrje në të. | Përmirësimi i krejt sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.<br><br>*Përshkrimi:*<br>- Krijimi i degëzimeve të reja për blloqe të reja e rikonstruksioni i rrjetit të vjetër.<br>- Shërbime në depo, klorinimi i rregullt, rritja e numrit të pikave të marrjes së mostrave për analizë.<br>- Zgjidhja teknike për realizimin e klorinimit për degëzimin për lagjen Gurra.<br>. | **1**<br><br>Afat shkurtër | Bashkia<br><br>Drejtoria e Ujësjellës - Kanalizimeve<br><br>Donatorët<br><br>Grupi i studimit hidroteknik | Sigurohet furnizimi i plotë më ujë të pijshëm e garantohet mbrojtja e tij nga ndotjet.<br>Rritet garancia për mbrojtjen e shëndetit të popullatës. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 4**<br><br>Keqadministrimi i mbetjeve urbane, shkarkimet abuzive të tyre në shumë zona dhe ndotje të mjedisit.<br><br>*<u>Përshkrimi:</u>*<br>Mosfunksionimi i një sistemi të largimit të mbeturinave urbane për të gjithë qytetin (mungon në L. Kodër-Marlekaj, Craj, Xhenjo, ish SMT, pjesërisht në L. Spitalit, Gurra etj).<br>- Mungesa e infra-strukturës rrugore për largimin e mbeturi-nave, e kontenierëve dhe automjeteve të përshtatëshëm, i pikave të grumbullimit në disa zona.<br>- Ndërgjegjësimi i pa-mjaftueshëm i publikut.<br>- Krijimi i vatrave të ndotura nga shkar-kime abuzive të m. urbane në vendet e sipërpërmendura. | Përcaktimi, ngritja e funksionimi efektiv i sistemit të largimit të mbeturinave urbane.<br>Hartimi i një plani veprimi e zbatimi i tij.<br><br>*<u>Përshkrimi:</u>*<br>- Përcaktimi i pikave, kohës, frekuencës, llojit të automjetit, për evadimin e mbeturinave dhe gjetja e burimeve financiare për këtë qëllim.<br>- Caktimi i ditëve për largimin e objekteve të ndryshme të vjetëruara nga banesat të nxjerra si mbetje.<br>- Ndërgjegjësimi i komunitetit për mbajtjen pastër të qytetit dhe aplikimi gjobave. | **1**<br><br>Afat shkurtër | Bashkia<br><br>D.SH.SH.P.<br><br>ARM-ja<br><br>Firma e pastrimit<br><br>Donatorët | Realizohet largimi i plotë i mbeturinave urbane të qytetit, bëhet pastrimi i qytetit dhe respektohet mjedisi urban në funksion të shëndoshjes së situatës së tanishme. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 5**<br><br>Mospërfundimi i fushës së mbeturinave për Lezhën.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Janë pezulluar punimet e ndërtimit të fushës së mbeturinave për qytetin e Lezhës që në shtator të vitit 2000. | Përfundimi i fushës së mbeturinave dhe paralelisht i të gjithë sistemit të largimit të mbeturinave<br><br>*Përshkrimi:*<br>- Kërkohet përfundimi i fushës së mbeturinave nga sipërmarrësit pasi është përfunduar hapja e gropës si dhe kërkohet sipas projektit vetëm një muaj kohë punime për këtë qëllim.<br>- Paralelisht kërkohet realizimi i një plan veprimi për ndërgjegjësimin e komunitetit.<br>- Krijimi i mundësive për zbatimin e teknologjive të reja dhe inisiativat ricikluese si dhe për prodhimin e biogazit nga fusha e mbeturinave.<br>. | **1**<br><br>Afat shkurtër | Bashkia<br><br>Investitori<br><br>Firma e ndertimit<br><br>ARM-ja | Administrohen mbeturinat në mënyrë të përshtatshme dhe ulet ndikimi i tyre në mjedis.<br><br>Eleminohen vatrat e ndotura me mbeturina. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 6**<br><br>Keqadministrimi i mbetjeve të ndryshme dhe ndotjet e shkaktuara prej tyre.<br><br>_Përshkrimi:_<br>Mbeturinat e ndërtimeve shkarkohen përgjithësisht në brigjet e lumit Drin, përrenjëve, kanaleve etj.<br>Mbetjet spitalore me groposje sipas rastit.<br>Mbetjet e lulishteve, kopshteve, blegtorale etj., në vende të pamiratuara.<br>Mbetjet nga serviset e automjeteve, karburantet, lokaleve të ndryshme në vënde të papërshtatshme.<br>Mungesa e varrezave të automjeteve.<br>Mungesa të riciklimit të mbetjeve. | 1. Rehabilitimi i vatrave të ndotura nga shkarkimet e mbetjeve të ndryshme.<br><br>_Përshkrimi:_<br>- Largimi i mbeturinave nga vatrat e ndotura në të dy anët e lumit Drin, në lagjen Xhenjo, L. ish SMT, kanalizimet periferike.<br>- Caktimi i vendit për varreza të automjeteve. | **1**<br><br>Afat shkurtër | Bashkia<br><br>Zyra e Urbanistikës<br><br>ARM-ja<br><br>D.SH.SH.P.<br><br>Donatorët | Bëhet shëndoshja e mjedisit urban. |
| | | 2. Zbatimi dhe mundë-imi i teknologjive e aktiviteteve ricikluese të mbetjeve.<br><br>_Përshkrimi:_<br>- Mundësimi i riciklimit të qelqit, letrës, metaleve etj.<br>- Përgatitja dhe zbatimi i një plan veprimi për këtë qëllim. | **3**<br><br>Afat mesëm | Bashkia<br><br>Zyra e Urbanistikës<br><br>ARM-ja<br><br>D.SH.SH.P.<br><br>Donatorët | Aplikimi i aktiviteteve e teknologjive ricikluese sjell përfitim të shumëfishtë. |

| Tematika | Problemi | Aktiviteti | Prioriteti (1-3) Afati kohor | Burimet financiare/ Përgjegjësia | Efekti |
|---|---|---|---|---|---|
| **MBROJTJA E NATYRËS**<br>Toka, konvertimi i brigjeve të Drinit, erozioni, shpyllëzimi, gjelbërimi, biodiversiteti, ekosistemet kritike dhe rreziku. | **Problemi 1**<br><br>Prishja e habitateve në të dy anët e lumit Drin (pjesa e qytetit).<br><br>*Përshkrimi:*<br>Është dëmtuar rëndë brezi me drurë dhe shkurre natyrore në të dy brigjet e lumit Drin dhe është varfëruar biodiversit-eti. | Restaurimi dhe përmirësimi i habitatit dhe biodiversitetit në të dy anët e lumit Drin.<br><br>*Përshkrimi:*<br>- Kryerja e studimit për zonën e "mbrojtur nga ndërtimet" dhe për zhvillimin e habitatit, restaurimi me mbjellje dhe harmonizimi me shëtitoren e objektet e tjera urbane. Përcaktimi i bimësisë dhe biodiversitetit që vendoset.<br>- Përgatitja dhe zhvillimi i planit të veprimit për këtë qëllim. | **3**<br><br><br><br>Afat gjatë | Bashkia<br><br>ARM<br><br>Donatorët<br><br>OJF-të | Përmirësohen vlerat e trashëguara natyrore të biodiversitetit dhe pejsazhit.<br><br>Rriten efektet tërheqëse të qytetit dhe vendet për çlodhje dhe ripërtëritje. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 2**<br><br>Rritja e erozionit të shpatit të kodrës së Kalasë dhe zbritja e prurjeve inerte në qytet në kohë reshjesh.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Dëmtimi i bimësisë së shpatit të kodrës së kalasë nga kullotjet, prerjet etj Mungesa e disiplinimit të ujrave sipërfaqësore të shpatit në një sistem efiçent kanalizimesh në të dy anët e përroskës afër Spitalit si dhe në shpatin mbi urën e vjetër. | Pyllëzime të shpatit të kodrës së Kalasë.<br>- Realizimi i një rrjeti kanalizimesh për disiplinimin e ujrave.<br>- Ndalimet e kullotjes<br><br>*Përshkrimi:*<br>- Pyllëzime në faqen jugore e perëndimore të shpatit të kodrës së kalasë, përcaktimi i vendeve të përshtatshme, ruajtja e tipareve natyrore të pejsazhit.<br>- Ndërtimi i një rrjeti ujëmbledhës efiçent në të dy anët e përroskës tek spitali si dhe po mbi këtë shpat mbi urën e vjetër.<br>- Hartimi i një plan veprimi për ndalimin e kullotjes, ndalimin e ndërtimeve të reja që dëmtojnë brezin vegjetativ dhe pejsazhin.<br>. | **1**<br><br><br><br><br><br>Afat mesëm | Bashkia<br><br>ARM<br><br>Donatorët<br><br>OJF-të | Pengohet rënia e inerteve me prurjet në rast reshjesh të vrullëshme si dhe eleminohet ndikimi në infrastrukturën urbane të qytetit. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 3**<br><br>Moslargimi i shpejtë i ujërave në raste reshjesh të mëdha, ngarkesa me inerte e tyre, përmbytjet e përsëritura.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Në raste reshjesh të shumta (mbi 200 mm) dhe për një periudhë të shkurtër ka ndodhur përmbytja e pjesëshme e qytetit të Lezhës (një pjesë e Lagjeve Skënderbeg dhe Beslidhja). Situata të tilla të përsëritura (1996, 1997 dhe 22 shtator 2002) shoqërohen me paralizimin e infrastrukturës urbane të qytetit, depozitime të mëdha inertesh nga prurjet dhe deri | Thellimi i shtratit të lumit Drin, rehabilitimi dhe përmirësimi i rrjetit hidrografik që lidhet me disiplinimin e ujrave dhe largimin e tyre.<br><br>*Përshkrim :*<br>Thellimi i shtratit të lumit Drin veçanërisht në grykëderdhje, rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve dhe të hidrovoreve dhe investime të reja në këtë drejtim | **1**<br><br>Emergjente dhe deri afatgjatë (sipas një plani veprimi) | Prefektura dhe dikastere qëndrore<br><br>Ndërmarrja e ujrave<br><br>Bashkia<br><br>Donatorët | Evitohet përmbytja e qytetit të Lezhës dhe garantohen dhe investimet e tjera. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 4**<br><br>Dëmtimi i pyjeve, (dhe habitateve) nga ndërtimet pa leje, prerjet e drurëve, kullotja e bagëtive, në shpatin e malit të Shelbumit (pjesa perëndimore), në shpatin mbi L. Kodër-Marlekaj dhe në zonën suburbane në përgjithësi.<br><br>*<u>Përshkrimi:</u>*<br>Në zonat e sipërpërmendura vihen re prerje të drurëve për ndërtime, (pishat e mbjella), bëhet kullotje, ndërtime e zabtime shpatesh duke dëmtuar bimësinë. | Përmirësimi i brezit të gjelbert nëpërmjet marrjes së një sërë masash sipas një plani veprimi.<br><br>*<u>Përshkrimi:</u>*<br>- Përgatitja dhe zabtimi i një plan veprimi për ndalimin e kullotjes në zonën urbane e suburbane - heqja e bagëtive.<br>- Monitorimi i gjendjes së pyjeve, inventarizimi dhe mbrojtja e drurëve pyjor.<br>- Përcaktimi i zonave të gjelbërta që nuk do të preken nga ndërtimet.<br>- Vënia në efiçencë e sistemit të gjobave. | **3**<br><br>Afat gjatë | Bashkia<br><br>ARM<br><br>Donatorët<br><br>OJF-të | Përmirësohen vlerat natyrore të trashëguara si pejsazh, habitat, biodiversitet si dhe zhvillohen brezat ekologjikë që do të përmirësojnë ato që ndodhen më në thellësi të qytetit. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 5**<br><br>Dëmtimi i habitatit, varfërim i biodi-versitetit, humbje të vlerave të pejsazhit në zonën "brinjët e kalasë".<br><br><u>*Përshkrimi:*</u><br>Dëmtimi i bimësisë së shpatit të kodrës së kalasë nga kullotjet, prerjet, ndërtimet pa leje kanë dëmtuar vlerat natyrore të trashëguara. | Pyllëzime të zonës "brinjët e kalasë" ose kurora e gjelbërt e shpatit të kodrës së Kalasë 30 ha.<br>- Ndalimi i kullotjes<br><br><u>*Përshkrimi:*</u><br>- Pyllëzime në faqen jugore e perëndimore të shpatit të kodrës së kalasë, (kurora e Lezhës) përcaktimi i vendeve të përshtatshme, ruajtja e tipareve natyrore të pejsazhit.<br>- Hartimi i një plan veprimi për ndalimin e kullotjes, ndalimin e ndërtimve të reja që dëmtojnë brezin vegjetativ dhe pejsazhin.<br>. | **2**<br><br><br><br><br>Afat mesëm | Bashkia<br><br>ARM<br><br>Donatorët<br><br>OJF-të | Përmirësohet sfondi i pjesës kryesore të qytetit, përmirësohet bio-diversiteti, pejsazhi, rriten hapësirat për çlodhje, turizëm etj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 6**<br><br>Dëmtime e mungesa të gjelbërimit brenda zonave urbane, lagjeve, blloqeve, etj<br><br>*__Përshkrimi:__*<br>Janë bërë dëmtime në lulishten në qendër të qytetit, lulishten tek bregu i Drinit (L. Beslidhja) tek lulishte "Blloku 11 Janari", në zonën e gjelbëruar, L. Gurra, në gjelbërimet e anëve të rrugëve dhe trotuareve, nga:<br>Ndërtimet;<br>Parkingjet e makinave ;<br>Pakujdesia e njerëzve;<br>Kullotjet etj. | Restaurimi dhe përmirësimi i gjelbërimit të qytetit në të gjithë elemetet urbanë të tij.<br><br>*__Përshkrimi:__*<br>Restaurimi i të gjitha zonave të gjelbërura që janë dëmtuar, rrethimi i tyre, ndërtimi i rrugëve dhe pengesave për të mos kaluar makinat, zbatimi i një plan veprimi për ndërgjegjësimin e qytetarëve. | **2**<br><br><br>Afat shkurtër | Bashkia<br><br>Firma e gjelbërimit<br><br>ARM<br><br>Donatorët<br><br>OJF-të | Përmirësohen vlerat më tërheqëse të qytetit të Lezhës, mbi të gjitha "mu-shkëria e qytetit". |

| Tematika | Problemi | Aktiviteti | Prioriteti (1-3) Afati kohor | Burimet financiare/ Përgjegjësia | Efekti |
| --- | --- | --- | --- | --- | --- |
| **SHËRBIMET URBANE** Burimet e energjisë. Informacioni, aspekti tregtar, transporti urban. | **Problemi 1**<br><br>Rjeti shpërndarës elektrik i amortizuar, mungesa e energjisë për ngrohje etj., në përgjithësi.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Rrjeti shpërndarës ajror dhe i amortizuar, kabina elektrike që nuk përballojnë ngarkesat dhe nuk kanë masa sigurie për njerëzit, ndërtime të banëesave nën kabllot e tensionit të lartë.<br>Studimet e reja pa studime për rrjetet elektrike. | Realizimi dhe zbatimi i një sistemi shpërndarës elektrik kabllor nëntokësor paralel me studimet e tjera për të gjithë qytetin.<br><br>*Përshkrimi:*<br>- Realizimi i studimit dhe zbatimi i projektit për rrjetin.<br>- Plan veprimi për marrjen e masave për mbrojtjen nga rreziku nga rrjeti i amortizuar, kabinat e dëmtuara, ndërhyrjet e kundërligjëshme etj. | **2**<br><br>Afat afatgjatë | Bashkia (Ndërmarrja Elektrike)<br><br>Donatorët | Përmirësohet shpërndarja e energjisë elektrike duke garantuar më mirë furnizimin. Modernizohet konstrukti urban i qytetit. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 2**<br><br>Mungesa në gjetjen e përdorimin e burimeve të tjera të energjisë.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Ka rritje të përdorimit të gazit për nevojat e banorëve.<br>Pallatet e reja nuk kanë sistem furnizimi qëndror me gaz.<br>Përdorimi i paneleve diellore është tepër i pakët për arsye të kostos së lartë.<br>Përdorimi në disa raste i lëndës drusore në zonat suburbane për ngrohje. | Plan veprimi për gjetjen e përdorimin e burimeve të energjisë e miradministrimin e saj duke minimizuar impaktin në mjedis.<br><br>*Përshkrimi:*<br>- Mundësimi i nismave të të gjitha llojeve që ofrojnë gazin si burim energjie si dhe energjinë diellore.<br>- Përdorimi i rrjeteve qëndrore të furnizimit më gaz.<br>- Marrja e masave për heqjen e plotë të përdorimit të drurit për ngrohje e gatim. | **3**<br><br><br><br><br>Afat gjatë | Bashkia<br><br>Zyra e Programim-Zhvillimit<br><br>Donatorët<br><br>OJF-të | Rritja e përdorimit të burimeve të energjisë që kanë më pak ose nuk kanë indikime negative në mjedis, kosto të pranueshme etj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 3**<br><br>Mungesa e rrjetit kabllor telefonik në të gjithë qytetin Lezhë<br><br>*Pershkrimi:*<br>Në bazë të nevoja-ve të zhvillimit urban sidomos atij periferik mungon rrjeti telefonik sipas zonave 01 - 07 në deri 1000 numra. | 1. Zgjerimi i rrjetit kabllor me shtylla druri.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Zgjerim i rrjetit telefonik kabllor me shtylla druri bëhet në kushtet e mungesës së studimeve dhe elementëve të tjerë të infrastrukturës. | 3<br><br>Afat mesëm | Albtelekom sh.a. Shoqëri anonime | Zhvillimi urban i Lezhës plotësohet me këtë element të rëndësishëm |
| | | 2. Zgjerimi i rrjetit telefonik në qytetin e Lezhës me kabllo nëntokësorë.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Zgjerimi bëhet me kanal 70x40 me pusetë në zonën DP. | 3<br><br>Afat mesëm | Albtelekom sh.a. Shoqëri anonime | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 4**<br><br>Mospërballimi i ngarkesave të kabinave elektrike si dhe mosrespektimi i kushteve teknike në disa prej tyre.<br><br>*<u>Përshkrimi:</u>*<br>Veçanërisht në përiudhën e ftohtë ka dëmtime në kabinat elektrike nga mospërballimi i ngarkesave dhe ndërprerje të furni-zimit me energji. Kushtet teknike shpesh rrezikojnë jetën e banorëve. | 1. Ndërtimi dhe shpërndarja e kabinave elektrike sipas kushteve teknike.<br><br>*<u>Përshkrimi:</u>*<br>Studimi i ngarkesave në transformatorët e kabinave në lagje, bllok banesazh etj., dhe rinovimi i tyre | **2**<br><br>Afat mesëm | Bashkia<br><br>Drejtoria Elektrike<br><br>Donatorët | Garantohet më mirë furnizimi me energji dhe evitohen rastet e rrezikshmërisë nga amortizimet në sistemin elektrik. |
| | | 2. Përdorimi në masë si burim energjie i gazit të lëngët.<br><br>*<u>Përshkrimi:</u>*<br>Promovimi i sistemeve lehtësuese e nxitja e aktiviteteve që bëjnë furnizimin me gaz të lëngët çon në uljen e përdorimit të energjisë elktrike. | **3**<br><br>Afat mesëm | Bashkia<br><br>Donatorët | |

| Tematika | Problemi | Aktiviteti | Prioriteti (1-3) Afati kohor | Burimet financiare/ Përgjegjësia | Efekti |
|---|---|---|---|---|---|
| **AKTIVITETI SOCIAL-KULTUROR**<br>Aktiviteti kulturor e artistik, turizmi, sporti, objektet turistike, guidat, agjencitë, muzetë, biblotekat etj. | **Problemi 1**<br><br>Objekte arkeologjike dhe historike të pambrojtura, të dëmtuara e të pamenaxhuara. Dëmtime të natyrës dhe pejsazhit përreth.<br><br>_Përshkrimi:_<br>Objekti Kalaja mesjetare, muret e portat e qytetit Liss dhe objekte të tjera të pambrojtura.<br>Shtëpitë muze dhe monumet kulture të parujtura dhe që dëmtohen.<br>Mungesa e një sistemi menxhues që të sigurojë të ardhura për ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre vlerave.<br>Mungesa e infrastrukturës për menaxhimin e tyre për turizëm. | Plan veprimi për restaurimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e fondit arkeologjik, objekteve me rëndësi historike.<br><br>_Përshkrimi:_<br>- Identifikimi i zonave arkeologjike që duhet të mbrohen dhe marrja e masave për këtë qëllim.<br>- Ndërtimi i infrastrukturës për mundësimin e menaxhimit të tyre, promovimi i guidave agjencive etj | 3<br><br>Afat. mesëm | Instituti i Monumenteve të Kulturës<br><br>Qendra Kulturore<br><br>Bashkia<br><br>Donatorët | Hidhen hapa në drejtim të sigurimit dhe menaxhimit të fondit arkeologjik, historik e kulturor duke repektuar mjedisin natyror. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 2**<br><br>Zënia e zonës arkeologjike të kalasë me ndërtime, dëmtimi i objekteve arkeologjike<br><br>*Përshkrimi:*<br>Në shpatin e kodrës së Kalasë së Lezhës, brenda mureve rrethuese të qytetit të vjetër Lisuss që është objekt arkeologjik janë bërë ndërtime të konsiderueshme duke dëmtuar zonën dhe objektet arkeologjike. Gjithashtu, ka humbje të vlerave të pejsazhit etj | Prishja e ndërtimeve pa leje dhe sistemimi i zonës me objekte arkeologjike.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Prishja e ndërtimeve të kësaj zone, eleminimi i mbetjeve dhe sistemimi i mjedisit. Përcaktimi i kufinjve të zonës dhe marrja e masave mbrojtëse | 3<br><br>Afat mesëm | Bashkia<br><br>Instituti Monumenteve të Kulturës<br><br>KRRT-ja<br><br>Policia Ndërtimore | Kthehet në identitet zona arkeologjike. Përmirësohen vlerat mjedisore e historike. Krijohen mundësitë për zhvillimin e turizmit. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 3**<br><br>Humbja e gjelbërimit në zonën arkeogjike.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Dëmtimi i elementëve natyrorë të gjelbërt në zonën arkeogjike, vendvarrimi i Skënderbeut, Kala, sheshi tek muret Ilire (shpati i | 1. Realizimi i projekt-ndërhyrjes për restaurimin dhe zhvillimin e vlerave historiko-natyrore si dhe harmonizimi midis tyre.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Realizim projekti për gjelbërimit e vendvarrimit të Skënderbeut, Kalasë, dhe sheshit tek muret Ilire (shpati i Kalasë) | **3**<br><br>Afat mesëm | Bashkia<br><br>Instituti i Monumenteve të Kulturës<br><br>Donatorët | Përfitimi i vlerave natyrore e historike, fillimi i menaxhimit të tyre nëpërmjet turizmit. |
| | **Problemi 4**<br><br>Dëmtimi i rëndë i objekteve arkeologjike e historike.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Ka shëmbje të mureve të kalasë së qytetit, dëmtim të portave, mureve ndarëse. | 2. Restaurimi i objekte-ve të dëmtuara që rrezikojn dëmtimin e metëjshëm të tyre.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Restaurimi i mureve të Kalasë, i portës, mureve rrethuese etj | **3**<br><br>Afat gjatë | Instituti i M.K.<br><br>Donatorët.<br><br>Bashkia<br><br>Ministria e Kulturës | Rifitohen dhe mbrohen objektet e dëmtuara. Krijohen kushte për menxhimin e tyre për turizëm. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 5**<br><br>Mungesa e hapësi-rave për sporte të ndryshme në natyre<br><br>*Përshkrimi:*<br>Përveç stadiumit aktualisht mungojnë fushat sportive të lojrave me top dhe sporteve të tjera në natyrë, mungojnë pishinat. | Kryerja e studimit, zonimi dhë dhënia akses për përfitimin e zonave të gjelberta sportive.<br><br>*Pershkrimi :*<br>Kryerja e studimit, zonimi dhë dhënia akses për përfitimin e zonave të gjelberta sportive, mbi kishën e Dom Lleshit, posht rrugës Shtraus, Grylkë Zezë. | **3**<br><br>Afat gjatë | Bashkia (Zyra e urbanistikës)<br><br>KRRT-ja | Zhvillohen e marrin përshtatje efektive mjediset natyrore duke përmirsuar aktivitetin sportiv të komunitetit. |

| Tematika | Problemi | Aktiviteti | Prioriteti (1-3) Afati kohor | Burimet financiare/ Përgjegjësia | Efekti |
|---|---|---|---|---|---|
| **QEVERISJA** Mënyrat e qeverisjes vendore, gjenerimi i të ardhurave (taksat), varfëria dhe ekonomia urbane | **Problemi 1**<br><br>Mungesa e organeve këshillimore përgjegjëse për hartimin e strategjive të zhvillimit.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Në organet e qeveri-sjes funksionojnë zyra edhe seksione që lidhen me problemet e mjedisit, megjithatë këto nuk arrijnë të programojnë dhe zgjidhin problemet e sotme mjedisore, në përputhje me legjislacionin dhe kërkesat e komunitetit. | 1. Ngritja e Bordit Këshillimor pranë Kryetarit të Bashkisë.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Ky Bord të përbëhet nga 9 – 13 anëtarë, nga specialistë: inxhinierë, ekonomistë, biologë, mjekë, punonjës të sektorit të mjedisit, biznesmenë e të | 3<br><br>Afat gjatë | Bashkia<br><br>Donatorët | Ndihmon në hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjive të zhvillimit. |
| | | 2. Ngritja e një seksioni pranë Bashkisë për zhvillimin e qëndrueshëm.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Ky seksion të përbëhet nga 3-5 vetë, specialistë në këto fusha: Biologji, inxhinieri, ekonomi etj. | 3<br><br>Afat gjatë | Bashkia<br><br>MPVD | Do të ketë një organ përgjegjës për zhvillimin i cili programon dhe zhvillon plane veprimi në këtë drejtim. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 2**<br><br>Prishja e mjedisit urban – mungesa e veprimit të policisë.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Dëmtimi i mjedisit urban nga ndërtime dhe ndërhyrje të paligjëshme, dëmtimi i lulishteve, kurorës së qytetit, gjuetija e paligjëshme etj. | 1. Ngritja e policisë bashkiake.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Për ndërhyrje në rastet e dëmtimeve të mjedisit urban lind si domosdoshmëri ngritja e policisë bashkiake në përbërje 5 veta, e cila të kryejë edhe detyra të tjera në vartësi të bashkisë. | **3**<br><br>Afat gjatë | Bashkia<br><br>M.P.V.D. | Garantohet mbrojtja e mjedisit urban. |
| | | 2. Veprime të përbashkëta të organeve të tjera policore (P.Pyjore, P. Ndërtimit, P. Rendit).<br><br>*Përshkrimi:*<br>Sigurimi i bashkëveprimeve në mes organeve policore për të realizuar ndërhyrjen e menjëherëshme ndaj dëmtuesve kundravajtës. | **3**<br><br>Afat gjatë | Bashkia | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 3**<br><br>Mungesa e njohjes së legjislacionit dhe e problemeve mjedisore nga të zgjedhurit dhe administrata publike.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Efektiviteti i pakët i punës së zyrave dhe seksioneve si dhe të zgjedhurve nëpërmjet komisioneve të përherëshme për zgjidhjen e problemeve të mjedisit. | 1. Kulifikimi nëpër-mjet trajnimeve.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Trajnim i administra-tës nëpërmjet seminareve për njohjen e legjislacio-nit mjedisor dhe situatës mjedisore. E njëjta gjë të bëhet me të zgjedhurit vendorë. | **1**<br><br>Afat shkurtër | Bashkia<br><br>ARM | Rritet shkalla e kualifikimit, ndër-gjegjësimit, kompetencës për të zgjidhur çështjet e mjedisit. |
| | | 2. Kualifikimi nëpër-mjet shkëmbimit të përvojës me njësitë homologe brenda dhe jashtë shtetit.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Grupi i përbërë nga të zgjedhurit vendorë dhe përfaqësues të administratës të organizojë aktivitete shkëmbimi përvoje | **1**<br><br>Afat shkurtër | Bashkia<br><br>ARM<br><br>Donatorë | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Problemi 4**<br><br>Pamjaftueshmëria e ndërgjegjësimit të komunitetit për mbrojtjen e mjedisit.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Me gjithë përpjekjet e bëra nga shoqatat mjedisore, mungesa e një ndërgjegjësimi të gjërë dhe të vazhdueshëm të opinionit publik për problemet e mjedisit. | 1. Nxjerrja e një organi periodik shtypi.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Botimi i një gazete 4 faqëshe mjedisore ku të trajtohen probleme të mjedisit e të ndërgjegjësohet komuniteti në lidhje me to | 3<br><br>Afat gjatë | Shoqatat mjedisore<br><br>Bashkia<br><br>Donatorët | Rritet ndjeshmëria e publikut për një qëndrim respektues ndaj mjedisit, mbrojtjen dhe përmirësimin e tij. |
| | | 2. Ndërgjegjësimi nëpërmjet rubrikave në TV lokal, posterave etj.<br><br>*Përshkrimi:*<br>Krahas posterave dhe spoteve televizive të organizohen periodikisht emisione problemore për mjedisin | 3<br><br>Afat gjatë | ARM<br><br>Bashkia<br><br>Donatorët | |

**Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVM) për qytetin e Lezhës u realizua nga bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet Bashkisë Lezhë, Qendrës Rajonale të Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) - Zyra në Shqipëri, Shoqatës "Eko-Integrim Retina" (EIRLA) Lezhë dhe ndihmesen financiare të Fondacionit SOROS.**